8 rregulla jonë ekzistonte që në fillim të gjykimit, a do të
9 ndryshonit ju tani parashtrimin tuaj?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk e ndryshojmë parashtrimin
11 tonë sepse në qoftë se rregulla ka ekzistuar apo s'ka
12 ekzistuar në çështjen Ruto, parimi vlen. Sa i takon mundësisë
13 së drejtë dhe të njëmendtë për të bërë kundërpyetje. Pra, edhe
14 me rregullën e re, duhet t'i jepet mundësia e përshtatshme dhe
15 e duhur për të bërë kundërpyetje. Me këtë përfundim doli
16 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, dhoma e apelit dhe
17 gjykata kushtetuese e kësaj Gjykate.

18 Dhe ashtu duhet të them, pavarësisht afatit kur doli,
19 kohës kur u krijua rregulla për çështjen Ruto, Gjykata
20 Kushtetuese këtu e ka autorizuar këtë rregull, por e ka thënë
21 shprehimisht që duhet të ketë mundësi të njëmendtë dhe të
22 përshtatshme që të bëhet kundërpyetje në mënyrë që të pranohet
23 një dokument sipas rregullës 143(2), dhe kjo nuk ka ndodhur.
24 Dhe çështja Ruto trajton pikërisht këtë, a është dhënë mundësi
25 e njëmendtë për të bërë kundërpyetje. Prandaj, paragrafi 93

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364 Faqe 93

1 shpreh të njëjtën gjë, është situata që kemi ne këtu. Thjesht
2 se na erdhi dëshmitari dhe u përgjigj gjithë kohën dhe tha
3 "s'e mbaj mend", "nuk e di", "nuk e njoh këtë", po kjo nuk
4 është një mundësi e drejtë dhe e përshtatshme për të bërë
5 kundërpyetjet.

6 Më lejoni të mbaroj. Pikërisht për këtë unë i përsërita
7 pyetjet e Prokurores. Nuk mund të ndodhë që përgjigjet e
8 dëshmitarit të vënë në dyshim vërtetësinë e deklaratës, dhe
9 Prokurores kjo i merret parasysh dhe Prokurorja thotë që jo,
10 në rastin tonë ai nuk ishte në përputhje, dhe i pranohet
11 parashtrimi, ama kur e ngre Mbrojta nuk i pranohet si
12 parashtrim.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do ju pyes diçka tjetër.
14 Dhoma e Apelit e TPN-së në çështjen Ruto tha që dëshmitari në
15 fjalë ndryshoi përmbajtjen e dëshmisë që kishte dhënë më
16 përpara. Në bazë të përgjigjeve që dha ky dëshmitar, a po
17 thoni ju që dëshmitari në rastin tonë po ashtu ndryshoi
18 përgjigjet?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Fakti që nuk i kujtohet, në një
20 farë mënyre është ndryshim, sepse nuk u jep të akuzuarve të
21 kundërshtojnë dëshminë. Dhe unë e quaj këtë ndryshim në
22 mënyrën se si e jep deklaratën. Është e rëndësishme që
23 Prokuroria të nxjerrë prova inkriminuese gjatë pyetjeve të
24 veta, në mënyrë që të akuzuarit më pas t'i ballafaqojnë këto.

25 Po ashtu do t'ju tërheq vëmendjen tuaj sa i takon

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364

Page 94

1 ndryshimit të dëshmisë së këtij dëshmitari, dhe më lejoni
2 sepse duhet të jap referencën, është faqja 7692, rreshti 11.

3 Pyetje:

4 "A ju kujtohet që personat që kanë urdhëruar rrahjen
5 ish-in Hashim Thaçi, Rexhep Selimi dhe Sabit Geci?"

6 Dëshmitari përgjigjet:

7 "Jo, nuk e kam thënë këtë, dhe as nuk më kujtohet.

8 "PY. Thjesht dua të kuptoj përgjigjen tuaj, ju po thoni
9 që ju kujtohet që nuk e keni thënë, apo nuk e keni thënë?

10 "PË. Nuk më kujtohet ta kem thënë që do të thotë s'e kam
11 thënë.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Më lejoni një pyetje tjetër
13 atëherë. Rregulla 143(2) e Rregullores së Procedurës së kësaj
14 Gjykate i referohet një skenari apo një situatë ku "dëshmitari
15 mendohet se ka njohuri të paktën sipas Trupit Gjykses,
16 dëshmitari nuk po bën asnjë lloj përpjekje për të dhënë
17 dëshmi". Në këtë formë është shprehur pak a shumë kjo rregull.
18 Duhet të bëjë përpjekje.

19 A mendoni ju se kjo e përshkruan saktësisht situatën tonë
20 me këtë dëshmitar kur i bëtë pyetje qoftë ju, qoftë dhe
21 Prokuroria?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni që të nxjerr pak
23 rregullën që të [Mikrofoni çaktivizuar].

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, arsyeja pse doja të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364 Faqe 95

1 sigurohesha unë për këtë pikë -- kemi 143(2) (b) madje. Kjo
2 dispozitë nuk lidhet me një deklaratë të mëparshme dhe
3 konsistente.

4 Këtu thuhet, mund të merret në pyetje një dëshmitar për
5 një çështje -- pra një çështje që logjikisht mund të supozohet
6 se dëshmitari ka dijeni dhe për të cilën sipas Trupit Gjykues
7 kur pyetet prej një pale, dëshmitari nuk bën një përpjekje të
8 njëmendtë për të dëshmuar. Pra, duhet të themi që përdorimi i
9 deklaratës duhet të jetë në fakt nën rregullën 143(2) (c).

10 Sepse ai duket se ka njohuri në bazë të deklaratave, në
11 bazë të informacionit që na kanë dhënë ne, nuk ka arsye
12 shëndetësore pse papritmas nuk i kujtohet më asgjë.

13 Dhe pjesa e dytë e pyetjes suaj, thatë a po bën ai një
14 përpjekje të njëmendtë. Pajtohem, po, nuk po bënte përpjekje
15 të njëmendtë për t'iu përgjigjur pyetjeve tona.

16 Por, duhet të jetë dhe pjesa (c) sa i takon deklaratave
17 të mëparshme mospërputhëse. Pra, dhe unë tani duhet të pyes ku
18 është dallimi tani mes 143(2) (c) dhe 155(2). Dallimi është
19 pikërisht pamundësia jonë për t'i bërë kundërpyetjet.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Më bëhet qejfi që e the se
21 këtu doja të dilja.

22 E thashë para dy ditësh të njëjtën pyetje. Nëse një
23 deklaratë pranohet sipas 155 apo 143, ju u pajtuat dhe jeni në
24 të njëjtin pozicion sa i takon mundësisë suaj për t'i bërë
25 kundërpyetje dëshmitarit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364

Page 96

1 Z. MISETIC: [Përkthim] E saktë.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po atëherë për çfarë arsye
3 parapëlqeni që të zgjidhni rregullën 155? Është sepse janë
4 strikte parakushtet?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Në fakt në një farë mënyre
6 këtë po përpiqesha të shpjegoja të hënën. Pse shkon Prokuroria
7 me rregullën 143(2) dhe jo rregullën 155? Edhe përgjigjja
8 është e dukshme sepse besojnë, e dinë shumë mirë që nuk i
9 përmbushin në fakt rregullën 155, që në fakt do të thotë nuk
10 është zbatuar siç duhet kjo rregull.

11 Por dallimi është ky. Së pari, 155 ka kaluar
12 kushtetutshmërinë nga Gjykata Kushtetuese për kundërpyetjet.
13 Dhe ne tani jemi në të njëjtin pozicion. Dhe unë do të
14 argumentoj se kushtet janë relativisht strikte, kur mund të
15 përdoret kjo gjë, sidomos duhet të ketë edhe prova që ka pasur
16 ndërhyrje. Dhe në këtë situatë, të drejtat e të akuzuarit për
17 t'u kundërpyetur po kundërpeshohen kundër një interesi
18 konkurrues. Kemi ndërhyrje me dëshmitarët dhe mospranimin e
19 kërkesës së Prokurorisë për t'u pranuar një dokument.

20 Në rregullën 143, nuk shfaqen interesa konkurrues që do
21 të cenonin të drejtat e të akuzuarit për të ballafaquar dhe
22 kundërpyetur dëshmitarin sipas Konventës Evropiane të të
23 Drejtave të Njeriut. Pra, unë them 155 qëllimisht është
24 shprehur në mënyrë të ngushtë, për të kufizuar të drejtat e të
25 akuzuarve për të bërë kundërpyetje, por në situata të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364 Faqe 97

1 jashtëzakonshme. Në këto situata, kur përmbushen kushtet,
2 atëherë mund të pranohet një dëshmi pa i bërë kundërpyetjet.
3 Por duke mos pasur këto situata, nuk mund të pranohet një
4 deklaratë e mëparshme mospërputhëse për vërtetësinë e
5 përmbajtjes sepse dëshmitari në fakt ka penguar si punën e
6 Prokurorisë, si punën e Mbrojtjes.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Të jem i qartë. Të drejtat e
8 të akuzuarve për të bërë kundërpyetje nuk kufizohen as me
9 rregullën 143, as me rregullën 155. Trupi Gjykues këtu ju kanë
10 dhënë ju mundësinë të bëni kundërpyetje. Ju nuk mund të thoni
11 ju që Trupi Gjykues ju ka kufizuar ju të drejtën për të bërë
12 pyetje.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Gjykata Kushtetuese ka dalë me një
14 konstatim prandaj është i rëndësishëm vendimi Ruto. Jo t'i
15 bëjmë thjesht pyetje sepse kemi fizikisht një dëshmitar. Duhet
16 të jenë pyetje të njëmendta në mënyrë që dokumenti të jetë i
17 pranueshëm.

18 Ne mendojmë që gabimi ndodhi me rregullën 143. Të
19 pranohet deklarata pa pasur dhe mundësinë në qoftë se --
20 Mbrojtja pati mundësinë t'i bënte pyetje të njëmendta
21 dëshmitarit. Ne besojmë se rregulla 143 duhet të zbatohet dhe
22 në qoftë se ndodh një situatë e ngjashme në të ardhmen, Trupi
23 Gjykues të presë një herë në qoftë se kundërpyetja bëhet siç
24 duhet, t'i vendosë shënimin për identifikim dhe në qoftë se
25 Mbrojtja kundërshton dhe Prokuroria dëshiron që një dokument

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364 Faqe 98

1 të pranohet sipas rregullës 143, atëherë le të shtjellohet kjo
2 më tej dhe të marrë vendimin Trupi Gjykues përkatësisht.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju thatë para dy ditësh që
4 *lex specialis* është rregulla 155 në këtë situatë.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do të thonit që këto dy
7 konstatimet që duket se janë dy dispozita të rregullores,
8 sidomos dy *lex specialis*, që është një arsyetim që dispozita e
9 duhur është dispozita 143(2) dhe dispozita tjetër është
10 rregulla 155(2). Pse duhet të zgjidhet patjetër një *lex*
11 *specialis* dhe jo domosdoshmërisht të dyja?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] E para një herë, ka dallime. Sepse
13 rregulla 143(2) parashikon mundësinë e drejtë dhe të
14 përshtatshme për të bërë kundërpyetje të njëmendta. 155(1)
15 thotë në qoftë se ka probleme shëndetësore nga ana e
16 dëshmitarit dhe kjo u pengon të drejtat e të akuzuarve për të
17 bërë kundërpyetje, lidhur me deklaratat që kanë ndodhur para 25
18 vitesh, por për shkak të Alzheimerit apo të sëmundjeve mendore
19 nuk mund t'u përgjigjet, atëherë materiali do të pranohet
20 sipas rregullës 155(1) dhe pastaj Trupi Gjykues do të vendosë
21 vetë çfarë peshe do t'u japë këtyre materialeve.

22 Por ju nuk mund ta pranoni këtë deklaratë sipas 143, apo
23 jo? Sepse nuk u është dhënë mundësi e drejtë dhe e njëmendtë
24 që të bëheshin kundërpyetjet, kështu që do të zgjidhnim 155 në
25 qoftë se do të kishim një pengesë mendore apo ndonjë problem

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364 Faqe 99

1 shëndetësor. E njëjta situatë është dhe për rregullën 155(2).

2 Sa i takon kërkesës së 143, përvoja jonë është që
3 përdorimi i një deklarate të mëparshme jopërputhëse sipas
4 rregullës 143, në situatat kur dëshmitari jep një deklaratë që
5 nuk është në përputhje, ne kemi kuptuar që kjo deklaratë mund
6 të përdoret vetëm duke i bërë shumë pyetje përmes deklaratës,
7 duke thënë, "Këtë po thoni tani. Por ama, ju kujtohet çfarë
8 keni thënë para 5 vjetësh?" Dhe mund t'ia shtrosh në këtë
9 formë pyetje dhe kështu mund të kontrollohet, verifikohet,
10 vërtetësia e përmbajtjes.

11 Ama nuk mund të bësh tre pyetje të cilat dalin se janë
12 mospërputhëse dhe papritmas pranohet e gjithë deklarata pa
13 zbuluar fakte të reja përmes pyetjeve të drejtpërdrejta. Ky
14 është një dallim tjetër mes rregullës 143 dhe 155.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull, faleminderit.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic, ndërkohë që
17 jeni në këmbë, dëshiroj t'ju bëj disa pyetje. Së pari, dua
18 t'ju pyes lidhur me mbështetshmërinë në çështjen Ruto dhe më
19 pas do t'ju pyes lidhur me atë çfarë ju thoni që është
20 qëndrimi i aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës
21 Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

22 E fillojmë njëra pas tjetrës. Sa i takon çështjes ose
23 precedentit të Rutos, në çështjen Ruto. Çfarë është dallimi i
24 rëndësishëm, domethënë cili është dallimi sipas mendimit tuaj
25 të rregullës tonë 143(2)(c) dhe rregullës 68(2)(d) mbështetur

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364 Faqe 100

1 në cilën është vendosur mbi çështjen Ruto? Dhe sigurisht në
2 rregullën 143(2)(c) të Rregullores tonë parashikohet deklarata
3 e vërtetësisë. Ndërkohë që në dispozitat e Gjykatës
4 Ndërkombëtare Penale nuk thuhet shprehimisht kjo gjë në
5 rregullën përkatëse të tyre. Si mund të na e shpjegoni këtë
6 krahasimin ndërmjet dy neneve të rregulloreve?

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Ndoshta nuk u shpreha siç duhet
8 apo nuk isha i plotë në përgjigjen që i dhashë Gjykatësit
9 Gaynor. Interpretimi ynë i rregullës 143(2) nuk është që mund
10 të pranoni të gjithë deklaratën me përjashtim të rasteve që
11 mund të pyesni të gjitha pyetjet që keni në deklaratë edhe
12 pastaj e pranoni deklaratën. Mënyra se si është formuluar kjo
13 rregull konkrete është që ju mund t'i bëni një pyetje
14 dëshmitarit kur jep një deklaratë jopërputhëse. Dhe kjo nuk do
15 të thotë "deklaratë e dëshmitarit", por ideja është që në
16 qoftë se përgjigja është e ndryshme, domethënë, kjo është
17 mënyra se si formulohet në nenin 143.

18 Një çështje për të cilën logjikisht mund të refuzohet se
19 dëshmitari ka dijeni apo për të cilën sipas Trupit Gjykses kur
20 pyetet prej një pale dëshmitari nuk bën përpjekje.

21 Dëshmitari thotë që kam qenë në vendin e krimit, këtë e
22 thotë në deklaratë e dëshmitarit dhe pastaj vjen këtu dhe nuk
23 jep atë përgjigje. Pra, a do të thotë kjo se në qoftë se
24 dëshmitari ka dhënë një dëshmi prej 300 faqesh për të gjitha
25 çështjet e mundshme, a do të thotë kjo që e gjithë deklarata

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364 Faqe 101

1 duhet që të pranohet? Ne themi që nuk duhet të jetë kështu.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po flas për bazën ligjore.

3 Për ndryshimin ndërmjet dy rregullave. Rregullës së DHSK-së

4 dhe rregullës që zbatohet asokohe nga Dhoma e Apelit e

5 Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Domethënë, rregulla 68(2)(d), e

6 Gjykatës Ndërkombëtare Penale, dhe nenit 143(2)(c).

7 A mendoni që interpretimi i bazës juridike mund të jetë i

8 ndryshëm sepse duket sikur baza e normativës ligjore e

9 Gjykatës Ndërkombëtare Penale nuk parashikon një skenar të

10 tillë.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë po them që ne nuk kemi pasur

12 mundësi që të bëjmë kundërpyetje të përnjëmendtë, reale, të

13 vërtetë.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'jua bëj këtë pyetje,

15 por unë po ju bëj këtë pyetje që pse mund të krahasojmë mollët

16 dhe dardhat me njëri-tjetrin.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë po them që po krahasojmë

18 mollët njëri me tjetrin, jo mollët dhe dardhat.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirë, në rregull, atëherë.

20 Do të bëj një pyetje në lidhje me këtë. Pra për çështjen e

21 kundërpyetjeve.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se do më pyesësh mua, nga

23 aspekti procedural ka ndryshim ndërmjet rregullave përkatëse

24 të dy Gjykatave, por për sa i takon thelbit është njëjta gjë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa i takon përsëri bazës

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364 Faqe 102

1 së vendimmarrjes në aktgjykimin kundër Rutos, aspekti kryesor
2 në këtë paragraf që lexuat ishte që dëshmitarët në këtë rast i
3 mohuan pretendimet. Këto janë shprehjet që ata përdorin.

4 Që në fakt, ata kanë dhënë deklaratatë të mëhershme dhe
5 pastaj kur kanë ardhur para Trupit Gjykes kanë dhënë
6 deklaratatë të ndryshme. Po thoni që faktikisht ne jemi në një
7 skenar të ngjashëm këtu?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Siç iu përgjigja edhe Gjykatësit
9 Gaynor, e vërteta është që dëshmitari e ndryshoi dëshminë e
10 vet. Tani çfarë kuptimi ka fjala "ndryshoi", është tjetër gjë
11 dhe këtë mund ta lexoni në vendimin e Dhomës së Apelit. I
12 thashë Gjykatësit Gaynor që ai e ndryshoi dëshminë. Për
13 shembull e përmenda këtu edhe pyetjen që iu bë lidhur me
14 faktin në qoftë se personat që e kishin urdhëruar rrahjen
15 ishin Hashim Thaçi, Rexhep Selimi dhe Sabit Geci. Kjo është e
16 para.

17 E dyta, është e rëndësishme që të lexohet më poshtë i
18 njëjti paragraf për të kujtuar gjithë kuptimin e bërjes së
19 kundërpvetjeve të duhura. Në këtë paragraf thuhet që dëshmia
20 inkriminuese nxirret nga Prokuroria, në pyetjet kryesisht të
21 Prokurorisë. Domethënë pavarësisht nga fakti në qoftë se ai
22 thotë që "s'më kujtohet", ose "e kam thënë ose s'e kam thënë
23 këtë gjë", ajo çfarë është e rëndësishme është që Prokuroria
24 të nxirrte këtë informacion, këto dëshmi nga dëshmitari.

25 Situata në të cilën jemi ne tani është që deklaratatë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364 Faqe 103

1 ofrohet për t'u pranuar, ndërkohë që dëshmitari ose e mohon
2 dëshminë e mëparshme, ose thotë që "nuk e kam bërë fare", "nuk
3 e kam thënë", "nuk e mbaj mend". Por le të themi për çastin që
4 deklarata është aty dhe disi proceduralisht, domethënë, kjo
5 është në një pozicion të tillë të paqartë. Por ne na vendosni
6 në një pozicion të vështirë, se Prokurorja i thotë dëshmitarit
7 që "Jo e ke thënë ti këtë", domethënë me fjalë të tjera ekipet
8 e Mbrojtjes detyrohen që t'ia nxjerrin vetë informacionin dhe
9 në fakt kjo është pjesa e punës së Prokurorisë.

10 Dhe kjo është pjesa kryesore e vendimit në këtë akt
11 gjyqësor që unë sapo e përmenda.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju thashë që do kaloj te
13 pjesa e kundërpyetjeve, të aspektit të kundërpyetjeve.

14 Ju cituat aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese. Por ka tri
15 fjalë të vogla që nuk i cituat, dhe këto fjalë janë "si
16 rregull", dhe pastaj vazhdon, presje, dhe vazhdon më tej pjesa
17 që cituat ju. Pra, që vazhdohet më tej dhe thuhet që kjo
18 mundësi zakonisht duhet që të çojë në mundësinë e drejtë dhe
19 të përnjëmendtë për kundërpyetje.

20 Pyetja që kam për juve është: Në qoftë se deklaratat dhe
21 burimet e cituara nga Gjykata Kushtetuese në këtë çështje, dhe
22 nga GJEDNJ-ja a janë absolute? Domethënë me fjalë të tjera,
23 qëndrimi juaj këtu në perspektivën e të drejtës kushtetuese
24 dhe të drejtave të njeriut, nuk mund të ketë asnjë rast
25 përjashtimor kur një deklaratë e një dëshmitari mund të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364 Faqe 104

1 pranohet në këto rrethana pa i dhënë mundësinë kundërpyetjeve
2 të duhura?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk po e them këtë gjë, sepse
4 kemi rregullat të cilat parashikojnë pranimin e deklaratave të
5 personave që kanë vdekur, ose rasteve të tjera. Por ajo çfarë
6 po them unë është që ju keni përpara një paragraf ku
7 diskutohet zbatimi i këtij parimi në kuadrin e rregullës
8 143(2)(c). Dhe këtu citohet konkretisht zbatimi i këtij
9 rregulli dhe kërkesa që Mbrojtjes duhet t'i jepet mundësia që
10 të bëjë kundërpyetje të vërteta, të përshtatshme, dhe detyrimi
11 i Trupit Gjykses që në qoftë se nuk ka ndodhur në kohën kur
12 është bërë deklaratë, si rregull i përgjithshëm të akuzuarve
13 duhet t'u jepet mundësi e vërtetë në një fazë të mëvontë të
14 procesit gjyqësor. Dhe, kjo mundësi sipas Dhomës parashikohet
15 shprehimisht në rregullën 143(3). Pra, pavarësisht në qoftë se
16 sipas 155 keni të drejtën që të kundërpyesni një dëshmitar që
17 e ka humbur aftësinë, sigurisht domethënë nuk thuhet kështu
18 nga GjEDNj-ja apo burime të tjera të së drejtës. Domethënë
19 qëndrimi ynë nuk është që kjo është një e drejtë absolute, por
20 rastet kur duhet të pranohen dëshmi të tilla janë të
21 përcaktuara shprehimisht nga legjislacioni.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Emmerson.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dëshiroj që të trajtoj një
24 çështje që duket sikur cek shumë prej pyetjeve që u bënë nga
25 Gjykatësi Gaynor dhe Gjykatësi Mettraux dhe përgjigjes që dha

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364 Faqe 105

1 Prokurorja.

2 Kërkimi i asaj që përbën *lex specialis* ndërmjet këtyre dy
3 dispozitave, është diçka që e parashtroi z. Misetic. Pra,
4 Mbrojtja thotë në mënyrë të pashmangshme që duhet të zbatohet
5 155(2). Megjithatë duhet të kemi parasysh që parimi i *lex*
6 *specialis* nuk është i vetmi parim në fuqi kur kemi të bëjmë me
7 dy rregulla që konkurrojnë me njëra tjetrën sipas Prokurorisë,
8 apo palë të tjera në diskutim. Dhe nuk është e thënë që kjo të
9 zbatohet mbi të njëjtat grupe faktesh.

10 Një element thelbësor bazik janë që kur dy dispozita
11 ligjore penale zbatohen në një situatë, dispozita më e
12 favorshme ndaj të akuzuarve duhet të jetë mbizotëruese.
13 Domethënë ky është parimi që quhet *lex mitior*, dhe në qoftë se
14 më lejoni të shprehem, *lexi mitior* është elementi më i
15 rëndësishëm i procedurës thelbësore në proceset penale, pra
16 përveç *lex specialis* duhet të shikojmë dhe parimin *lex mitior*.

17 Pra ajo çfarë kemi këtu është që situata është e tillë që
18 në qoftë se dëshmitari vjen në Gjykatë, dhe dua që të shikoj
19 formulimin ekzaktësisht siç thuhet. Vetëm më lejoni një çast
20 që ta gjej referencën në dokumentet përpara. Pra, në
21 155(2) (a), thotë që "ndër faktorët e pranimit të deklaratave
22 janë dëshmia gojore duke përfshirë edhe rrethanat në të cilat
23 jepet dëshmia".

24 Dhe në këto rrethana, ligjbërësi ka vendosur që deklarata
25 e mëhershme e dëshmitarit mund të pranohet vetëm në qoftë se

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364 Faqe 106

1 përmbushet kërkesa kumulative e përgjithshme që parashikohet
2 nga 155(2) (b), dhe sipas kësaj pike, pra 155(2) (b) pra "duhet
3 që të merren parasysh kërcënimet, dëmtimet, shtrëngimi, etj."
4 Domethënë është e rëndësishme që të gjithë këta elementë të
5 merren në tërësinë e tyre.

6 Ajo çfarë është e rëndësishme është që rregulla 155(2)
7 parashikon një garanci për të akuzuarit, që kjo zbatohet në
8 këtë rast. Domethënë me fjalë të tjera, kjo duhet të
9 përmbushet si një precedent, si një kusht precedent. Si
10 rezultat nuk e ka tërësisht të hapur zgjedhjen Trupi Gjykues
11 që thjesht të zgjedhë ndërmjet dy dispozitave dhe të vendosë
12 se cilat janë dokumentet që duhet të pranohen në prova
13 materiale. Sepse në qoftë se do ta bënte këtë, kjo do t'i
14 mohonte të akuzuarit mbrojtjen që është parashikuar nga
15 ligjbërësi. Që sipas ligjbërësit duhet të aplikohen në një
16 situatë të ngjashme.

17 Nuk mund të ketë asnjë rast më të qartë në një situatë ku
18 bëhet fjalë për dy rregulla të cilat edhe në qoftë se në parim
19 mbivendosen, domethënë në qoftë se kemi parimin *lex specialis*
20 që aplikohet, nuk bëhet fjalë fare që qasja e duhur është që
21 duhet marrë parasysh të drejtat e të akuzuarit, pra nuk duhet
22 të mohohen të drejtat e të akuzuarit për mbrojtjen që atyre u
23 jepet nga ligji. Duhet të shikohet aspekti material thelbësor
24 dhe si rezultat refuzimi për të dëshmuar i dëshmitarëve duhet
25 që të jetë si rezultat i frikësimit ose shtrëngimit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364

Page 107

1 Domethënë mendoj që kjo është e qartë si përgjigje për
2 një situatë të tillë. Në qoftë se nuk e trajtojmë këtë në
3 thelb, me përjashtim të rastit nëse Trupi Gjykues konstaton që
4 të akuzuarit nuk duhet t'u mohohet mbrojtja ligjore që u jepet
5 nga ligjvënësi, besoj që është e qartë që kë rregull të
6 zbatojnë, kë dispozitë ligjore të zbatojnë. Dhe përgjigja e
7 drejtpërdrejtë është që duhet të zbatohet ai ligj që është më
8 i favorshëm për të akuzuarit. Kjo është parimi i dukshëm i të
9 drejtës penale. Mua më duket sikur nuk ka asnjë lloj
10 alternative tjetër Trupi Gjykues të paktën sipas 155(2).

11 Të paktën unë, shoh që nuk është se është kaq e
12 rëndësishme që të identifikohet se cili është ndryshimi i
13 formulimit të rregullores së Gjykatës Ndërkombëtare Penale,
14 dhe të rregullores tonë. Kemi dy rregulla. Pra, edhe në qoftë
15 se Mbrojtja [ka të] drejtë atëherë zbatohet *lex specialis* por
16 edhe në qoftë se do ta kemi gabim ne, ju duhet të mbështeteni
17 në parimin që ka të bëjë me favorizimin e të akuzuarve. Ky
18 është një parim i përgjithshëm, sepse në të kundërt, në qoftë
19 se do të bënit një gjë të ndryshme nga kjo, kjo do të ishte
20 cenuese për të drejtat e të akuzuarve. Në veçanti në rrethanat
21 kur ligjvënësi ka thënë shprehimisht që një gjë e tillë nuk
22 duhet absolutisht të ndodhë. Përjashtimi është vetëm në qoftë
23 se provohet nga Prokuroria që arsyet që pse dëshmitari jep një
24 dëshmi të ndryshme është se është nën kërcënim.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar dhe teksti i redaktuar sipas Urdhrit Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364

Faqe 108

1 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
2 Dëshiroj që të ngre diçka lidhur me 155(2)(b) dhe ndikimin që
3 ka të bëjë, domethënë, mosdhënia e dëshmisë është ndikuar
4 thelbësisht nga ndërhyrjet e palejueshme përfshirë këtu
5 kërcënim, frikësim, lëndim, ofendim, parash ose shtrëngim.

6 Atëherë, duke iu kthyer dëshmisë së dhënë nga dëshmitari
7 të hënën, dua që ta ilustroj për shembull në qoftë se do
8 shikojmë transkriptin në faqen 95, rreshti 24, pyetja që u bë
9 nga Prokurorja ishte:

10 "A e mbani mend që keni shprehur ndonjë herë frikë sa i
11 takon informacionit që keni dhënë lidhur me ngjarjen

12 [REDAKTUAR]

13 "PË. Nuk kam thënë asnjëherë që kam pasur frikë."

14 Pra, është e qartë ajo çfarë tha dëshmitari. Dhe nga
15 dëshmia që ai jep, i takon që nuk është kaq i besueshëm lidhur
16 me përgjigjet e veta.

17 Dhe nuk kam asgjë tjetër për të thënë, përveçse kjo
18 lidhet e shpjegohet shprehimisht në rregullën 155(2)(b).

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
20 Barthe.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam një pyetje pak të vonuar
22 për z. Misetic. Domethënë, dua t'i përgjigjeni një pyetjeje,
23 z. Misetic në qoftë se mendoni që ky dëshmitar është përpjekur
24 me të vërtetë, ka bërë një përpjekje të përnjëmendtë për t'iu
25 përgjigjur pyetjeve. Dhe çfarë mendoni ju sa i takon

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364 Faqe 109

1 përpyqjes së tij? Edhe çfarë mund të thoni sa i takon
2 kërkesës së Trupit Gjykses për të dhënë dëshmi?

3 Z. MISETIC: [Përktim] Jam plotësisht dakord me juve. Ne
4 themi që në këtë rregull të veçantë në aspektin procedural nuk
5 duhet të vazhdojmë në këtë mënyrë. Duhet ta ketë në dorë
6 Prokuroria që të marrë masa të ndryshme nga disa masa që ka në
7 dispozicion. Dhe prandaj bëme ndërhyrjen të hënën, sepse pse
8 na duhet ne si Mbrojtje që të detyrojmë dëshmitarin që të japë
9 dëshmi, sepse në fund të ditës është dëshmitar i Prokurorisë
10 dhe Prokuroria duhet të gjejë mënyrën për ta detyruar atë që
11 të japë dëshminë, për shembull të shikojë kartelën mjekësore,
12 ta kërcënojë që do ta çojë në burg në qoftë se nuk thotë të
13 vërtetën ose të zbatojë le të themi parashikimet e tjera të
14 cilat parashikohen në rregullën 155.

15 Megjithatë, ne nuk themi -- kjo është diçka e cila është
16 gabim nga aspekti procedural, nga kuadri procedural, mendoj që
17 nuk është qasja e duhur kjo. Jam i sigurt që nuk do jetë hera
18 e fundit që do bëjmë kërkesa të cilat lidhen me paragrafin
19 143(2).

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përktim] Faleminderit për përgjigjen.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përktim] Do bëjmë
22 pushimin e drekës.

23 Prokurorja donte të thoshte diçka.

24 ZNJ. MAYER: [Përktim] E vlerësoj atë çfarë tha Misetiç
25 dhe Tully, e vlerësoj që u munduan që të bëjnë një përmbledhje

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364

Faqe 110

1 të asaj që tha Prokuroria, megjithatë ne jemi në gjendje që të
2 flasim vetë.

3 Sa i takon pyetjeve që kanë të bëjnë me marrjen në pyetje
4 të dëshmitarit, është e qartë nga procesverbali që nuk ka
5 pasur pikë frikësimi, megjithatë ashtu siç besoj që ka dalë në
6 pah për Trupin Gjykses, ka dallim ndërmjet rregullës 143 dhe
7 155, përfshirë këtu edhe elementin e ndikimeve të
8 papërshtatshme që absolutisht nuk përfshihet në rregullën 143.
9 Siç e ka shqyrtuar edhe Trupi Gjykses nuk duhet të merret
10 parasysh parimi *lex specialis* në situata kur nuk i kemi të
11 gjithë këto elementë të marrë së bashku me njëri tjetrin.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Një çast ju lutem. Më lejoni t'i
13 kundërpërgjigjem.

14 Z. Emmerson po ashtu dëshironte që t'i përgjigjej.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Një fjali, do them.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Secili një
17 fjali.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Dallimi ndërmjet 155 që kërkon
19 ndërhyrje dhe 143 që nuk kërkon ndërhyrje, unë personalisht
20 nuk mund ta imagjinoj për një skenar ku ju pranoni një dëshmi
21 mbështetur në rregullën 143 ku Prokuroria të bën kërkesë që të
22 pranosh provat në bazë të 155(2) dhe i takon që 155 nuk ka
23 pikë rëndësie pastaj.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Edhe unë të njëjtën gjë do të
25 thoja. Nuk e kam fjalën për sjelljen e kësaj Prokurorie, por e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364 Faqe 111

1 kam fjalën për mundësinë e spekulimit, të hamendësimit. Çfarë
2 vlere ka që ligjvënësi të përfshinte kriteret konkrete në
3 rregullën 155(2) në qoftë se do të përmbusheshin të gjithë
4 faktet që mund të ekzistonin në këtë rast nën 143.

5 Të gjitha vendimet gjyqësore mbi legjislacionin duhet të
6 bëhen duke i parë të gjithë dispozitat ligjore në tërësinë e
7 vet. Është e rëndësishme që të gjeni një konstruksion ose një
8 praktikë është që është përputhëse, sepse nuk do të kishte
9 absolutisht asnjë lloj rrethane, pavarësisht se çfarë zgjedh
10 Prokuroria të bëjë. Por nuk do të kishte rrethana që të çonin
11 në rregullën 155 në qoftë se do mjaftonte 143.

12 Domethënë edhe në qoftë se bëjmë një interpretim të
13 thjeshtë edhe mbështetur në bazën e prezumimit thelbësor të të
14 qenit në favor të të akuzuarit, me thënë të drejtën as kjo nuk
15 është se ka ndonjë rëndësi shumë të madhe, sepse është
16 absolutisht parimi i përgjithshëm juridik që rregullat duhet
17 të lexohen dhe të kuptohen në tërësinë e vet.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim]

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam një pyetje tjetër për
20 ju z. Misetiç.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk do më duhet të shkoj në
22 palestër se kam ecur shumë lart e poshtë.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po mirë atëherë.

24 Atëherë, të jem i qartë. Parashtrimet tuaja janë gjysma e
25 saktë, pra, me çfarë thoni ju, i referoheni paragrafit 2 të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas Urdhrit
Gojor të 9 tetorit 2023 dhe CRSPD364 Faqe 112

1 rregullit 145 [sipas përkthimit] domethënë nuk mbështeteni tek
2 paragrafi 1 i rregullës 155, apo jo? Që ta kuptojmë drejt.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Ja që të sigurohem një çast ju
4 lutem. Atëherë, nuk e di në qoftë se më thoni që është 155(1)
5 nuk kam parë asgjë nga një dëshmi që personi ka pasur ndonjë
6 dëmtim, kështu që ajo çfarë thatë ju është e drejtë, domethënë
7 që mbështetem në rregullin 155(2), vetëm.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
9 do bëjmë pushim deri në orën 14.30. Dhe në orën 14.30 do
10 fillojmë me dëshmitarin e radhës.

11 Jemi në seancë private, do i kërkoja Sekretares të na
12 kalojë në seancë publike.

13 ~~{Seancë e hapur}~~

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
15 jemi në seancë publike.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
17 pushim deri në orën 14.30.

18 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.00

19 --- Seanca rifillon në orën 14.30

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës, dua
21 të ngre një gjë përpara se të futet dëshmitari nëse më lejoni.
22 Është e ngjashme me mocionet që kemi bërë lidhur me
23 dëshmitarët e tjerë të këtij lloji. Lidhur me faktin që
24 opinionet nuk duhet të merren nga ky dëshmitar, por në rastet

1 kur duhet të merret një dëshmi e tillë, duhet të vendoset baza
2 mbi të cilën merret këtë, dhe opinioni i këtij dëshmitari nuk
3 duhet të ndikojë mbi vlerësimin e çështjeve.

4 Kjo është një çështje e qëndrueshme për ne, përmendim
5 herë pas here, megjithatë deshëm ta ngrinim këtë dhe ta
6 vendosim në procesverbal që në këtë pikë është diçka e
7 përsëritur.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
9 z. Roberts.

10 Tani do të thërrasim dëshmitarin të vijë në sallë,
11 Sekretarja, Dëshmitari W03724.

12 Besoj se do ta bëjmë në seancë të hapur publike.

13 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, të nderuar
14 Gjykatës. Kryesisht po, por siç kam diskutuar *inter partes* me
15 palën Mbrojtëse, janë nja dy tre çështje të cilat janë
16 konfidenciale dhe prandaj do të kërkoj të kalojmë në seancë
17 private vetëm për të trajtuar këto dy a tre çështje.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord.

19 Diçka tjetër znj. Prokurore. Pas këtij dëshmitari nesër,
20 a kemi dëshmitar tjetër?

21 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo, ky është dëshmitari i fundit
22 që kemi për këtë javë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe sa kohë
24 mendoni se do t'ju duhet?

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Më pak se një orë përfshirë

1 deklaratën 154, 30 deri në 40 minuta.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po nga palët
3 Mbrojtëse a ka ndonjë ndryshim?

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Për pak më shkurt.

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] E kam parashikuar dy orë, më duket
6 një orë, një orë e gjysmë.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kemi ndryshime në qëndrimet
8 tona.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Është vështirë të thuhet tani, por
11 do thoja jo më shumë se një orë apo një orë e gjysmë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord.

13 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
15 t'ju kërkoja që të ngriheshit në këmbë dhe një herë vetëm për
16 një çast.

17 Sekretaria do të japë betimin solemn të dëshmitarit që ne
18 do t'ju kërkojmë që ta bëni në pajtim me rregullat tona. Ju
19 lutemi hidhini një sy, lexojeni me zë të lartë.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
21 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
22 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe
23 vetëm të vërtetën, dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të
24 cilën kam dijeni.

25 DËSHMITARI: W03724

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
2 uleni.

3 Dëshmitar, do të fillojmë dëshminë tuaj e cila do të
4 vazhdojë sot dhe nesër. Prokuroria siç e dini do t'ju bëjë së
5 pari pyetjet pasi të kenë përfunduar ata, pala Mbrojtëse ka të
6 drejtën t'ju bëjë pyetjet e saj, dhe anëtarët e Trupit Gjykses
7 po ashtu mund të kenë pyetje për t'ju bërë.

8 Prokuroria ka parashikuar që pyetjet e saj të zgjasin
9 rreth një orë. Pala Mbrojtëse ka parashikuar gjashtë deri në
10 shtatë orë. Ne shpresojmë që të gjithë Avokatët të
11 shfrytëzojnë kohën në mënyrë sa më të efektshme. Trupi Gjykses
12 mund të lejojë pyetjet vijuese në qoftë se përmbushin kushtet.

13 Ju lutem që t'ju përgjigjeni pyetjeve qartë dhe me fjali
14 të shkurtra. Në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen, kërkoni
15 Avokatëve që ta përsërisin apo t'i thoni që ta sqarojnë. Ju
16 lutem tregoni edhe se mbi ç'bazë jepni përgjigjet tuaja mbi
17 ç'baza apo rrethana.

18 Në rast se ZPS-ja ju kërkon që të flisni lidhur me
19 korrigjimin që i bëni deklaratave tuaja, do t'ju kërkohet që
20 të konfirmoni që deklaratat me shkrim që janë pjesë e listës
21 së korrigjimeve, përfaqësojnë deklaratën tuaj në mënyrë sa më
22 të saktë.

23 Ju lutem flisni në mikrofon apo para mikrofonit. Prisni
24 pesë sekonda përpara se t'i përgjigjeni pyetjeve, dhe flisni
25 me ngadalësi me qëllim që të mund të përballojnë punën

1 përkthyesit.

2 Kur jepni dëshmi para këtij Trupi Gjykues nuk lejohet që
3 të diskutoni me askënd jashtë kësaj salle përmbajtjen e
4 dëshmisë suaj. Në qoftë se ndonjë person ju bën pyetje jashtë
5 sallës së gjyqit, ju lutem që të na njoftoni menjëherë.

6 Edhe disa komente përfundimtare. Ju lutem që të ndaloni
7 të flisni në qoftë se unë ngre dorën, që do të nënkuptojë që
8 unë mund të kem një udhëzim të veçantë për t'ju dhënë.

9 Në qoftë se keni nevojë për pushime, ju lutem të kërkonte
10 dhe do të përpiqemi që të përmbushim kërkesën tuaj.

11 Pra do të fillojmë me ZPS-në që ndodhet në të majtën
12 tuaj.

13 Ju e keni fjalën.

14 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryegjykatës.

15 Pyetje nga znj. Mayer:

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

17 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Jemi takuar më parë, por e paraqis
18 veten edhe një herë. Jam Deborah Mayer, jam Prokurore e ZPS-
19 së. Ju lutem më thoni emrin.

20 PË. Robert Macfie Douglas Young.

21 PY. Dhe si ju quajnë?

22 PË. Douglas apo Doug.

23 PY. Cila është data dhe vendi i lindjes?

24 PË. Inverness, Skoci, 23 tetor 1948.

25 PY. Dhe kombësia?

1 PË. Britanike?

2 PY. Zotëri, a i keni dhënë një deklaratë ZPS-së në maj 2019
3 dhe në tetor 2019?

4 PË. Po.

5 ZNJ. MAYER: [Përkthim] I kërkoj Trupit Gjykses që të
6 vendosë në ekran 08592-085979 [sipas përkthimit] në anglisht,
7 076162-0716199-AT [sipas përkthimit] RED2 në shqip. Faqen e
8 parë për të dy deklaratat, ju lutem.

9 PY. A është ky dokument procesverbali i intervistës suaj me
10 ZPS-në?

11 PË. Po.

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim] A mund të kalojmë në faqen e
13 fundit të variantit në anglisht?

14 PY. A është kjo firma juaj në fund?

15 PË. Po.

16 PY. A keni patur mundësinë ta rishikoni këtë dokument para se
17 ta firmosni?

18 PË. Po.

19 PY. A keni patur mundësinë që t'i hidhnit një sy kësaj
20 deklaratë javën e shkuar?

21 PË. Po.

22 PY. A ju kujtohet që u takuat me mua dhe me kolegët e mi të
23 dielën e shkuar?

24 PË. Po.

25 PY. Në këtë takim, a ju është dhënë mundësia që të bënit

1 sqarime lidhur me dokumentin?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe në fakt a keni bërë sqarime ndaj kësaj deklarate?

4 PË. Po.

5 PY. A ju kujtohet nëse këto sqarime janë bërë pjesë e një

6 shënimi të cilin jua kemi lexuar?

7 PË. Po.

8 PY. Përveç korrigjimit që paraqitet në këtë shënim,

9 informacioni i këtyre deklaratave për ZPS-në, a është i saktë
10 me aq sa keni dijeni dhe besoni ju?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe përveç korrigjimeve të këtij shënimi, informacioni i

13 deklaratave tuaja për ZPS-në a përfaqëson atë që do të

14 deklaronit nëse do t'ju pyesnin sërish për ngjarjet të cilat

15 përmbahen atje?

16 PË. Po.

17 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Pasi i kemi përmbushur kriteret e

18 rregullës 154, kërkojmë që të pranohet dëshmia e këtij

19 dëshmitari përfshirë edhe provat materiale të shoqëruara të

20 cilat janë pjesë e Shtojcës 4, të cilat janë pranuar nga Trupi

21 Gjykues si pjesë e parashtrimeve të protokolluara F01700, së

22 bashku me shënimin përgatitor. Do t'i jap listën e të tërë

23 këtyre dokumenteve, numrin e tyre rendor, për Sekretarinë.

24 Deklarata që është në ekran ka shifrën 085942-085979.

25 Varianti në shqip është 076162-076199-AT RED2.

1 Prova e parë shoqëruese është 067049-067409 [sipas
2 përkthimit].

3 E dyta 070749-070749 [sipas përkthimit] .

4 Prova e tretë shoqëruese 076053-067055 [sipas
5 përkthimit].

6 Tjetra 050557-050557.

7 Tjetra 067870-067896.

8 Tjetra 067057-067066.

9 Tjetra është SPOE00059409-00059410.

10 Tjetra SPOE00233976-00233979

11 Tjetra SPOE000059421 [sipas përkthimit] deri në 00059423.

12 E treta SPOE00116964-00116973.

13 Tjetra ka një variant më pak të redaktuar që është në
14 radhën e dokumenteve. Mocioni 154 ka shifrën SPOE00233678 deri
15 në 00233681. Dhe varianti me pak redaktime, që ne besojmë që
16 dëshiron Trupi Gjykues dhe pala Mbrojtëse, 00340840-00340843.

17 Dokumenti tjetër SPOE00116952-00116963.

18 Tjetra ka një variant me pak redaktime për të cilin kemi
19 autorizim për përdorim që ka SPOE00233674 deri 00233677, e
20 cila është edhe pjesë e mocionit 154 të ZPS-së, sipas vendimit
21 të Trupit Gjykues. Varianti me pak redaktime ka shifrën
22 SPOE00116160 [sipas përkthimit] deri 00116763.

23 Provat materiale që mbeten, po filloj edhe një herë U007-
24 9610 deri në U007-06961 [sipas përkthimit] RED 2, që është një
25 dokument shumëgjuhësh, për të cilin ka dy përkthime, në

1 anglisht pasi janë vetëm dy faqe që janë përkthyer në gjuhën
2 angleze. Shumica e tij është në anglisht. Dy faqet me përkthim
3 në anglisht janë 007-9616 deri në U007-679616-ET [sipas
4 përkthimit] dhe e dyta është 0007-9618 [sipas përkthimit]
5 deri në 007-9620-ET RED2.

6 Dhe dokumenti i fundit i shoqëruar është 067054 [sipas
7 përkthimit] deri në 067048 RED2 në anglisht. Varianti shqip i
8 secilës është 067045-067048-AT RED2.

9 Dhe dokumenti përgatitor që po paraqesim është 115157-
10 115161.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
12 kundërshtim?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

14 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo.

15 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
17 Dokumentet e numëruara plus prova materiale shoqëruese do të
18 pranohen dhe do të marrin numrin rendor përkatës të provës.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
20 nderuar Gjykatës.

21 I pari 085942 deri në 085972, dhe përkthimi i tyre në
22 shqip 076162 deri në 076199-AT, i rishikuar, RED2 do të ketë
23 provën P392.

24 E dyta, 067049-067049 do të ketë numrin P393.

25 I treti, 050549-05049 [sipas përkthimit] do të ketë

1 provën P394.

2 067053 deri në 067055 ka provën P395.

3 050557 deri në 050557, do të ketë numër të provës P396.

4 067870 deri në 067896, do të ketë numrin e provës P397.

5 067057 deri në 067066 do të ketë numrin P398.

6 SPOE00059409 deri në 00059410 do të ketë provën materiale

7 P399.

8 SPOE00233976 deri në 00033979 [sipas përkthimit] do të

9 ketë provën P400.

10 SPOE00059421 deri në 00059423 do të ketë provën materiale

11 P401.

12 SPOE00116964 deri në 00116973 do të ketë provën materiale

13 P402.

14 SPOE000340840 [sipas përkthimit] deri në 00340843 do të

15 ketë provën materiale P403.

16 SPOE001116952 [sipas përkthimit] deri në 00116963 do të

17 ketë numrin P404.

18 SPOE00116760 deri në 00116763 do të ketë provën materiale

19 P405.

20 U007-9610 deri në U007-961 [sipas përkthimit] RED2 dhe dy

21 përkthimet e identifikuar do të kenë provën P405. Dhe

22 përkthimet do të jenë me ET.1 dhe ET.2.

23 067045 deri në 067048 RED2 do të jetë prova P406.

24 Dhe në fund, shënimi përgatitor 115117 [sipas përkthimit]

25 deri në 115161 do të ketë provën materiale P407.

1 ZNJ. MAYER: [Përkthim] E di që është një listë shumë e
2 gjatë. A mund t'i kërkoj një sqarim? Mund të kem shënuar që
3 SPOE00116760 deri në 673 [sipas përkthimit] që të ishte 405
4 dhe tjetra pasuesja ka shifrën 405. Po kështu duhej të kisha
5 numrat e saktë përpara se t'i përdorja.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] SPOE0167 [sipas
7 përkthimit] do ketë P407 [sipas përkthimit]. U007-9610 deri në
8 U007-9621 do ketë P406. Kërkoj ndjesë. 067045 [sipas
9 përkthimit] do të ketë provën materiale 407. Dhe shënimi
10 përgatitor do të jetë 408.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Cili ishte i
12 fundit?

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] 408.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prova
15 materiale nga P932 deri në P408, pranohen.

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Më 9 shtator, ZPS-ja ka paraqitur
17 një përmbledhje të deklaratës të këtij dëshmitari, sipas
18 rregullës 154, nuk kemi marrë ndonjë kundërshtim nga palët dhe
19 me lejen e Trupi Gjykses do ta lexoj këtë përmbledhje.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

21 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Douglas Young ka shërbyer si një
22 nënkolonel rezervist i ushtrisë britanike dhe është dislokuar
23 si pjesë e KDOM-it, Misionit të Vëzhguesve Diplomatikë dhe si
24 pjesë e Misionit Verifikues të OSBE-së (KVM) në vitin 1998 dhe
25 1999.

1 Z. Young është larguar nga Kosova në mars 1999 kur, para
2 se të fillonte fushata bombardues e NATO-s dhe u kthye duke
3 shërbyer në radhët e KFOR-it nga tetori 2001 deri në prill
4 2002.

5 z. Young ka marrë pjesë për krijimin dhe drejtimin e
6 Qendrës Koordinuese të KVM-së numër 1 dhe ka shërbyer si
7 zëvendës koordinues me fushë përgjegjësie Rahovecin dhe
8 Malishevën dhe i ka raportuar Qendrës Rajonale 1 që ishte me
9 seli në Prishtinë. Gjatë gjithë kësaj kohe në Kosovë z. Young
10 ka bashkëpunuar me UÇK-në lidhur me personat e zhdukur dhe të
11 rrëmbyer. Z. Young ka bashkëpunuar me UÇK-në për të gjetur se
12 ku ndodheshin këta persona të rrëmbyer nga UÇK-ja dhe për të
13 siguruar lirin e tyre.

14 Në një rast të tillë z. Young u përpoq që të kërkonte
15 lirin e një personi të rrëmbyer, Ymer Xhafiqi ditën e
16 ndaluar nga UÇK-ja dhe ka patur një numër shkëmbimesh atë ditë
17 me zyrtarë të UÇK-së.

18 PY. Z. Young, keni thënë që keni shërbyer si rezervist i
19 ushtrisë britanike, përfshirë disa dislokime në vitet 1990,
20 dhe këto si pjesë të deklaratës suaj për ZPS-në. A mund t'i
21 tregoni Trupit Gjykues lidhur me karrierën tuaj ushtarake, në
22 përgjithësi?

23 PË. Shumica e shërbimit tim është bërë si pjesë rezerviste me
24 kohë të pjesshme në Britani. Jam stërvitur dhe kam punuar në
25 Mbretërinë e Bashkuar, shpesh jam dislokuar në Gjermani në

1 Rajn, po kështu dhe në Norvegji dhe në Qipro.

2 Unë jam rritur në pozitë duke marrë gradën e majorit në
3 vitin 1980, pasi kisha shërbyer si një komandant i një toge të
4 këmbësisë dhe të mortajave dhe si zyrtar i kundërzbulimit.
5 Kam shërbyer në vitin 1989, isha me këmbësinë kur kam
6 shërbyer me ushtarët e ndërlidhjes si pjesë e divizionit të
7 dytë të këmbësisë dhe të divizionit të dytë dhe kam shërbyer
8 në Gjirin Persik në vitin 1990 si pjesë e operacionit të
9 Stuhisë -- së atëhershme.

10 Në jetën civile shërbeva si jurist në një praktikë
11 private dhe pastaj 15 vite në qeverinë lokale si nëpunës
12 zyrtar. Më pas kam dalë vullnetar për t'u mobilizuar sërish
13 për të shkuar në Bosnjë. Në vitin 1996, unë isha major dhe kam
14 shërbyer dy herë në këtë rol. Pastaj jam rritur në gradë
15 përmes sistemit britanik. Dhe më është kërkuar që të shërbeja
16 edhe për një periudhë tjetër si një zyrtar i lartë i
17 ndërlidhjes i divizionit britanik në selinë në Sarajevë.

18 Pra, kam shërbyer në Bosnjë për një vit. Pas emergjencës
19 në Kosovë, Ministria e Jashtme britanike më ka kërkuar që të
20 shkoja fillimisht për KDOM-in Britanik që më pas u transferua
21 në Misionin Verifikues të Kosovës për OSBE-në. Kam shërbyer me
22 to në Kosovë dhe në Maqedoni.

23 Pasi jam kthyer në Britani, dhe jam kthyer në jetën
24 civile, jam mobilizuar sërish për të punuar me KFOR-in. Pjesë
25 e kësaj pune ishte që të shërbeja për të shndërruar Trupat

1 Mbrojtëse të Kosovës e cila përbëhej nga veteranët e Ushtrisë
2 Çlirimtare të Kosovës. Ishte një kohë mjaft e vyer për mua dhe
3 kam shërbyer për këtë një periudhë gjashtëmujore që është
4 dislokimi i fundit në kuadrin e shërbimit si ushtarak.
5 PY. Siç keni dëgjuar këtu, deklarata jua e ZPS-së është
6 provë materiale dhe ne do t'ju kërkojmë që të përsërisni atë
7 që keni dhënë në deklaratë. Megjithatë aty keni diskutuar
8 mënyrën se si i keni kryer detyrat tuaja si pjesë e qendrës
9 koordinuese CC1 dhe se si kjo qendër ka hartuar raportet
10 ditore.

11 Dua që t'ju kërkoj të komentoni mbi këtë dokument, do i
12 kërkoj Sekretarisë të paraqesë në ekran SPOE0016730 [sipas
13 përkthimit]. Ju lutem hidhini një sy në ekran.

14 PY. Në krye të kësaj faqeje, në faqen 1, data është 26 janar
15 1999. A ishit zëvendës drejtori i CC1 në Misionin Verifikues
16 të Kosovës në këtë datë, më 26 janar 1999?

17 PË. Po. Më duhet të them që unë u bëra zëvendës drejtor gjatë
18 këtij turneu shërbimi. Më përpara kam qenë komandant i një
19 patrulle. Komenti që përmbahet në këtë dokument, që thuhet që
20 "Është komenti i drejtorit të komanduar" apo ushtruesit të
21 detyrës së drejtorit --

22 PY. Më lejoni që t'ju bëj pyetjen tjetër. Tani unë ju kam
23 pyetur vetëm për datën. Pra, a ishit ju duke shërbyer në këtë
24 datë?

25 PË. Po.

1 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në fund të faqes 2 të këtij

2 dokumenti.

3 PY. Do t'ju kërkoja që të flasim lidhur me pjesën përpara
4 shtojcës. Titulli juaj këtu është Drejtor i CC1 në detyrë. A
5 mund ta shpjegoni?

6 PË. Funkzioni im quhej zëvendës drejtor. Megjithatë, drejtori
7 George Bordet, nuk ishte i disponueshëm për shkak se ishte
8 sëmurë me një infeksion të rëndë. Dhe duke qenë që nuk i
9 kryente dot funksionet, atëherë të gjithë e kanë kuptuar që
10 pjesë e përgjegjësisë sime ishte që të shërbeja si një
11 ushtrues së detyrës së drejtorit.

12 PY. Dhe duke qenë që ky dokument mban emrin tuaj, a është ky
13 dokument i cili ju e keni hartuar vetë apo e keni miratuar
14 këtë?

15 PË. Po.

16 PY. T'i kthehemi edhe një herë faqe së parë këtij dokumenti.
17 Në pikën 2, në fund të faqes, në pjesën e dytë të pikës numër
18 2, aty ku fillon me fjalën kur thuhet "Një makinë patrulluese
19 e CC1..."

20 Dhe dua që të përqendrohemi në tre rreshtat e fundit të
21 këtij paragrafi.

22 "Patrulla e KVM-së është ndaluar nga UÇK-ja të cilët
23 pretendonin se nuk ishin paralajmëruar nga formacionet e tyre
24 të nivelit më të lartë lidhur me këtë patrullë. Detajet e
25 tjera do të vijojnë më tutje. E njëjta shenjë njoftuese është

1 bërë edhe gjatë kësaj kohe”.

2 Desha të pyes së pari për termin “formacion më i lartë”.

3 Kur e keni përdorur për këtë, çfarë keni nënkuptuar?

4 PË. Ky është një term i veçantë ushtarak i cili ka të bëjë me
5 selinë më të lartë në një zinxhir komandues. Formacion i
6 lartë, ose më i lartë është thjesht eprorët e asaj patrulle të
7 UÇK-së që ne kemi hasur në atë moment.

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do ta ofroj SPOE0001673 [sipas
9 përkthimit] deri në SPOE00116733 që të pranohet si provë
10 materiale.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

15 [Përkthim] SPOE00116730 deri në 0016733 pranohet.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të ketë provën
17 materiale P409.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 Mund të vazhdoni, Prokurore.

20 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Tani dëshiroj t’ju tregoj një
21 dokument që i kërkoj Sekretares të paraqitet në ekran. Është
22 dokumenti SPOE00060949 deri në SPOE00060951.

23 PY. A e keni parë këtë dokument më përpara, dëshmitar?

24 PË. Po, më është treguar më herët.

25 PY. A ju është treguar gjatë seancës përgatitore të

1 Prokurorisë të dielën?

2 PË. Po.

3 PY. A mund të thoni se çfarë lloj dokumenti është ky?

4 PË. Po.

5 PY. A keni mbërritur në Kosovë për këtë Misionin në nëntor
6 1998, domethënë për misionin që diskutuam më herët për 1998
7 dhe 1999?

8 PË. Po.

9 PY. Dëshiroj që t'ju tërheq vëmendjen te faqja e dytë e këtij
10 dokumenti. Fillojmë me fillimin e faqes. Thuhet: Misioni
11 Verifikues i Kosovës, raporti i ndërmjetëm që mbulon periudhën
12 nga 24 nëntori 1998.

13 Pyetja e parë që kam për juve është kjo: A jeni njohur me
14 këtë lloj dokumentesh apo raportesh atëherë kur jeni dërguar
15 në Kosovë për herë të parë?

16 PË. Nuk mendoj që i kam parë këto lloj dokumentesh në mënyrë
17 të rregullt, si rutinë, por herë pas here i kam parë.

18 PY. E kuptojmë. Për të qenë të qartë, ju nuk jeni autori i
19 këtij raporti, apo jo? Nuk e keni shkruar ju këtë raport?

20 PË. Po, e saktë është kjo.

21 PY. Dëshiroj t'ju kërkoj që të shihni paragrafin, ose më
22 shumë se paragrafin, pikën 2, domethënë tek pika 2,
23 nënparagrafi i dytë. Dhe ajo çfarë raportohet në këtë raport
24 janë "Zhvillimet në zonën e Misionit". Në këtë pjesë thuhet që
25 ka pasur një takim me komandantin e UÇK-së dhe KDOM-i është

1 informuar se ka marrë një direktivë të re nga "niveli i lartë
2 i UÇK-së". Në të thuhet që:

3 "UÇK-ja duhet të ndihmojë dhe të mbështesë organizatat
4 ndërkombëtare dhe nuk duhet të ndërtojë pengesa në rrugët
5 kryesore dhe jo të provokojë policinë serbe".

6 A është kjo në pajtim me informacionin që ju ka ardhur në
7 dijeninë tuaj ose që keni mësuar ju kur keni qenë në 1998?
8 PË. Po, më kujtohet që ta kem dëgjuar këtë lloj informacioni,
9 këto lloj hollësisht, jo domosdoshmërisht sipas formulimit
10 këtu, por ka pasur probleme të kësaj natyre që kanë ndodhur në
11 atë kohë kur jemi vendosur aty. Të paktën sa i takon OSBE-së
12 fillimisht, për të bërë monitorimin e zbatimit të marrëveshjes
13 midis Milosevic dhe Holbrooke, sigurisht ne ishim përgjegjës
14 për monitorimin e tërheqjes së forcave serbe.

15 Dhe sigurisht që gjithmonë e më tepër punonim ose merrnim
16 informacion që kishte të bënte me UÇK-në, komunikatat e UÇK-
17 së, dhe kemi vëzhguar dhe vetë pak a shumë të njëjtat situata
18 edhe në terren. Kjo është diçka e cila mua më kujtohet që të
19 ketë ndodhur në atë kohë.

20 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kërkoj që të paraqitet në ekran
21 dokumenti U002-2849 deri në dokumentin U002-2851-ET. Versioni
22 në gjuhën shqipe mban të njëjtin numër identifikimi ERN-je,
23 por nuk ka ET në fund.

24 PY. Ndërkohë që shfaqet dokumenti në ekran, dëshmitar,
25 dëshiroj që të shikoni faqen e parë të dokumentit në ekran.

1 Shikojmë pak titullin, si dhe paragrafin e plotë, paragrafin e
2 parë e kam fjalën. Ku thuhet që:

3 "Edhe pse Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të
4 Kosovës nuk është nënshkruesi i asnjë marrëveshjeje..."

5 Do ta kaloj këtë pjesë, pastaj do ta vazhdoj me gjysmën
6 tjetër të paragrafit kut thuhet që:

7 "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka njoftuar se do t'u
8 ofrojë ndihmë dhe bashkëpunim mekanizmit të përmendur duke iu
9 mundësuar që pa pengesë t'i kryente detyrimet dhe obligimet e
10 veta në të gjithë territorin që kontrollohet nga UÇK-ja. Ata
11 nuk do të pengohen në lëvizjet e tyre në terren dhe ju
12 garantojmë siguri të plotë."

13 A është kjo në pajtim me atë çfarë sapo diskutuam që
14 ishte e pasqyruar në raportin e OSBE-së, lidhur me kushtet që
15 ekzistonin asokohe. Si ishte situata në terren atëherë?

16 Z. MISETIC: [Përkthim] E kundërshtoj mënyrën se si është
17 bërë pyetja. Mënyra se si u formulua pyetja, kërkon spekulim.
18 Është spekulim sepse nuk ka bazë, nuk ka bazë. Dokumenti i
19 mëparshëm nuk shërben si bazë për këtë dokument.

20 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kam përshtypjen që e përcaktova
21 bazën kur bëra pyetjet në raportin e mëparshëm. Në qoftë se i
22 ka parë këto dokumente. Nuk i bëra këto pyetje lidhur me këtë
23 dokument, por pyetja që bëra ishte në qoftë se ajo që
24 reflektohet që përshkruhet në këtë dokument përkon me përvojën
25 e tij në terren në Kosovë.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

2 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do t'i bëj pyetje në qoftë se
3 përshkrimi përkon me përvojën e tij.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] ju lutem,
5 riformulojeni ndryshe.

6 Pjesërisht pranohet kundërshtimi i Misetiç.

7 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

8 PY. Ta bëj ndryshe pyetjen. A e keni shkruar ju këtë raport
9 apo jo?

10 PË. A e kam shkruar unë?

11 PY. Po.

12 PË. Jo.

13 PY. A e ke lexuar këtë dokument të UÇK-së më përpara,
14 domethënë këtë raport, e ke lexuar më përpara se sa t'ju
15 tregohej të dielën gjatë takimit me Prokurorinë?

16 PË. Jo, nuk mendoj se jo.

17 PY. Duke kuptuar këto pengesa që ky është dokument që ju e
18 keni parë vetëm disa ditë më përpara, kjo fjali në paragrafin
19 që jua lexova dhe pjesën tjetër, e parë në pamje të parë a
20 mendoni që reflektimi, përshkrimi i kushteve në terren është i
21 njëjti me kushtet që keni parë ju vetë me sytë tuaj në terren.

22 PË. Në përgjithësi është në përputhje me atë çfarë kam parë.
23 Megjithatë, sa i takon kësaj deklaratë që nuk do të
24 bllokoheshin, ne nuk jemi bllokuar. Në raste të caktuara, për
25 shembull një herë jam filmuar edhe nga BBC-ja në një punkt të

1 UÇK-së se ishte bllokuar dhe mund të kaloja, dhe mbaj mend
2 edhe një vend tjetër ku ka pasur një bllokim permanent, por
3 patëm mundësi që të negocionim. U lejova që të mbushej me
4 karburant makina. Këto kanë qenë disa raste kur ka pasë
5 bllokime. Por, në përgjithësi kishim mundësi që të kalonim
6 lirisht pa pengesa.

7 PY. E kuptoj.

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretares së Gjykatës
9 që të paraqesë dokumentin që kishim në herët në ekran. Për
10 referencë është dokumenti SPOE0006049 [sipas përkthimit] deri
11 në SPOE00060951, faqja 2 përsëri e këtij dokumenti. Paragrafi
12 i dytë, nën pikën 2.

13 PY. Ndërkohë që paraqitet në ekran, dua t'ju bëj pyetjen.
14 Këtë dokumentin që pamë më herët, titullin e kishte "Shtabi i
15 Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës". A e dinit ju
16 se ku e kishte vendin Shtabi i Përgjithshëm në UÇK? Domethënë
17 ishte në majë të UÇK-së, në fund të organizimit të UÇK-së?

18 PË. Ishte në krye të organizimit. Megjithatë, edhe termi
19 Shtab përdoret ndonjëherë. Dhe kur flisnim përmes përkthyesve,
20 përkthyesit përdornin të dyja shprehjet, Shtabi i Përgjithshëm
21 ose ShP. Por jam i sigurt që të dyja nënkuptonin të njëjtën
22 gjë.

23 PY. Tani, iu kthjem përsëri këtij dokumentit të OSBE-së.
24 Është një dokument që e diskutuam pak çaste më përpara. Është
25 dokument i 23 [sipas përkthimit] nëntorit të vitit 1998,

1 atëherë paragrafi 2 nën pikën 2. Ku thuhet që dikush nga KDOM-
2 i kishte pasur një takim me një komandant të UÇK-së që kishte
3 marrë një direktivë të re "nga maja e UÇK-së", ose nga eprorët
4 e UÇK-së. A e shikoni këtë pjesë të paragrafit, dëshmitar?

5 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Po diskutonim
6 për raportin e OSBE-së, për Sekretaren, kështu që ju lutem mos
7 e hiqni nga ekrani.

8 PY. E shikoni dokumentin, e shikoni përpara në ekran?

9 PË. Po, e shikoj. E shikoj paragrafin e dytë të pikës 2, që
10 kishin marrë udhëzim nga udhëheqja e UÇK-së, nga strukturat më
11 të larta të UÇK-së.

12 PY. Na treguat për datën e raportit të OSBE-së që ishte 24
13 nëntori 1998.

14 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do kërkoja që t'i hidhnim një sy
15 edhe një herë dokumentit të UÇK-së që është dokumenti U002-
16 2851. Faqja e fundit që mban numrin U002-2849, deri në U002-
17 2851, në të dyja versionet, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën
18 angleze. Numri ERN është i njëjtë për të dyja versionet.
19 Kalojmë tek faqja e dytë e këtij dokumenti në të dyja gjuhët
20 nëse është e mundur.

21 PY. A e shihni datën e këtij dokument në fund të faqes,
22 dëshmitar?

23 PË. Po, e shoh.

24 PY. Data është 19 nëntor 1998, që i takon që është pesë ditë
25 përpara 24 nëntorit 1998.

1 PË. Po.

2 PY. Besoj se shikoni edhe versionin në shqip që është në të
3 majtë të ekranit që ka vulë dhe nënshkrim, apo jo dëshmitar?

4 PË. Po.

5 PY. Faleminderit. Z. Young, dëshiroj t'ju tërheq vëmendjen
6 ndaj ngjarjeve të caktuara të cilat ju i cekni në dëshminë
7 tuaj që pasqyrohen në provën materiale P392 dhe provën
8 materiale P407, siç keni deklaruar për ZPS-në ashtu edhe në
9 deklaratën prej katër faqeve që keni hartuar për TPNJ-në.
10 Sërish nuk do t'ju kërkoj që të përsërisni çdo gjë që keni
11 deklaruar, por dua të tërheq vëmendjen tuaj në pjesë të
12 caktuara të deklaratës.

13 Në atë deklaratë duke filluar nga faqja 15 deri 26, ju
14 keni përshkruar në hollësi në disa faqe se si e keni marrë
15 vesh që ishte rrëmbyer Amir [sipas përkthimit] Xhafiqi. Pra,
16 ti i shpjegon se e ke mësuar si ka ndodhur kjo gjë më 9 mars
17 1999, dhe që keni organizuar një takim me zyrtarë të UÇK-së
18 kur mësuar për rrëmbimin e tij. Përshkruani deklaratë tuaj që
19 jeni takuar me zyrtarë të ndryshëm të UÇK-së në vende të
20 ndryshme, në përpjekje për të gjetur vendin se ku ndodhej ky
21 person, pra Amir [sipas përkthimit] Xhafiqi.

22 Së pari dua që t'ju tërheq vëmendjen në bisedë që keni
23 bërë që ju përshkruani si një grup shtëpish në afërsi të
24 Dubravës. A ju kujtohet kjo pjesë e deklaratës suaj?

25 PË. Po.

1 PY. Në atë pjesë të deklaratës ju thoni se përfunduat duke u
2 takuat me dikë që quhej Komandant Drini. Vazhdoni më tej dhe
3 thoni që keni diskutuar me Komandant Drinin lidhur me dijeninë
4 që kishte ai lidhur me këtë rrëmbim. A mund t'i tregoni Trupit
5 Gjykues se çfarë ju tha Komandant Drini se çfarë dinte ai
6 lidhur me këtë rrëmbim përpara se sa t'jua sillte atë në
7 vëmendje?

8 PË. Komandant Drini ma bëri shumë të qartë mua personalisht
9 se sipas atij, ai nuk kishte fare dijeni për rrëmbimin dhe që
10 rrëmbimi nuk ishte bërë mbi bazën e urdhrave të veta, por që
11 do të bënte hetimet e veta. Ai arriti shumë shpejt së bashku
12 me drejtorin tonë rajonal, pasi unë i thashë atij se cilat
13 ishin dyshimet tona për sa i takon përgjegjësisë lidhur me
14 rrëmbimin e personit në fjalë.

15 PY. Në të njëjtën deklaratë ju përshkruani se keni përfunduar
16 edhe duke takuar dikë që e kishte emrin Skënder që ju kuptuat
17 që ishte komandant i Brigadës 124 të UÇK-së. A mund t'i
18 tregoni Trupit Gjykues në qoftë se ju morët vesh në qoftë se
19 ai në një mënyrë ose në një tjetër ishte i përfshirë me
20 rrëmbimin e Imir Xhafiqit?

21 PË. Po. Biseda me Skënderin ndodhi përpara se sa të mbërrinte
22 Drini. Drini erdhi vetëm si rezultat i raportimit që i bëra
23 unë Skënderit, lidhur me atë çfarë kishte ndodhur. Skënderi
24 fillimisht më tha mua se ai dhe me sa dinte ai, UÇK-ja nuk
25 ishte i përfshirë në zhdukjen e z. Xhafiqi. Megjithatë, gjatë

1 bisedës, për shkak të diçkaje që tha Skënderi, unë e kuptova
2 që ai duhet të ishte i përfshirë. Dhe kjo pastaj më çoi mua që
3 të raportoja atë zhvillim në Shtabin tonë, në selinë tonë
4 kryesore në Prizren përmes radiolidhjes.

5 PY. Në rregull. Pasi folët me Komandant Drinin, a shkua me
6 pas në takimin në Tërpezë, në mënyrë që të mësonit më tepër
7 lidhur me këtë rrëmbim?

8 PË. Po.

9 PY. Dëshiroj që të përqendrohemi në takimin e dytë që keni
10 mbajtur në Tërpezë. Thoni në provën materiale P392 dhe
11 gjithashtu në provën materiale P407, se përfunduat duke u
12 takuar me dikë që u prezantua ose që ju besoni që ishte
13 Çeliku. Dhe që më pas juve zbuluat se cili ishte identiteti i
14 këtij personi, ose mësuat se kush ishte ky personi. Kush ishte
15 ky Çeliku që ju takuat në Tërpezë kur shkua për të diskutuar
16 rrëmbimin e Xhafiqit?

17 PË. Çeliku ishte Fatmir Limaj. E dija këtë gjë në fakt
18 atëherë, e dija që Çeliku ishte nofka e z. Limaj. Unë nuk e
19 kisha takuar asnjëherë më parë atë, megjithatë gjatë takimit
20 kur u bë i vështirë takimi, mua m'u tha nga kolegët e mi që
21 personi ishte Fatmir Limaj, për të cilin kisha dëgjuar më
22 herët. Dhe siç e thashë unë e dija që më përpara që ai e
23 kishte nofkën Çeliku.

24 PY. Gjatë bisedës që patët me Fatmir Limajn, a e pranoi ai se
25 UÇK-ja e kishte ndaluar këtë person, pra Amir [sipas

1 përkthimit] Xhafiqin?

2 PË. Po.

3 PY. Sa zgjati biseda me të, me z. Limaj?

4 PË. Është e vështirë të thuhet, ndoshta 15 minuta. Nuk është
5 se ishte shumë e shkurtër, por nuk ishte as shumë e gjatë. Në
6 thelb mund të them që nuk po arrinim një marrëveshje, dhe u
7 ndamë si rezultat.

8 PY. Sa larg ishit prej tij kur e patët këtë bisedë me të?

9 PË. Isha shumë pranë tij.

10 PY. A e kuptuat ju se çfarë niveli përgjegjësie kishte Fatmir
11 Limaj kur po fliste me juve lidhur me faktin që UÇK-ja kishte
12 kontroll ose e kishte ndaluar këtë burrë, domethënë në çfarë
13 cilësie fliste Fatmir Limaj në bisedën me ty?

14 PË. Po. Një prej pikave të mia për këtë takim, një prej
15 pikave që do të diskutoja, ishte që unë isha atje i autorizuar
16 nga Komandant Drini, i cili dëshironte që unë të paktën të
17 kisha qasje për ta parë këtë personin e ndaluar. Dhe sa më
18 përket mua, unë e kisha mbështetjen e Komandant Drinit, kisha
19 lejen e Komandant Drinit me vete. Dhe e thashë këtë gjë, ia
20 tregova këtë gjë z. Limaj. Megjithatë z. Limaj m'u përgjigj se
21 personi i ndaluar ishte jashtë përgjegjësisë së komandantit të
22 zonës dhe se ishte nën kompetencën ose autoritetin e Shtabit
23 të Përgjithshëm.

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do ju kërkoj
25 që të kalojmë shkurtimisht në seancë private për pyetjet

1 pasuese.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

3 [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Mund të kalojmë në seancë

4 private, znj. Sekretare?

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W03724 (Seancë private)
Pyetje nga znj. Mayer

Faqe 139

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03724 (Seancë private)
Pyetje nga znj. Mayer

Faqe 140

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W03724 (Seancë private)
Pyetje nga znj. Mayer

Faqe 141

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W03724 (Seancë private)
Pyetje nga znj. Mayer

Faqe 142

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2 [Seancë e hapur]

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private
4 [sipas përkthimit], të nderuar Gjykatës.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
6 Mbrojtësi i z. Selimi do t'ju bëjë pyetjet tani.

7 Z. Roberts, ju e keni fjalën.

8 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, më lejoni një
9 sekondë sa të rregulloj pak ekranin.

10 Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts:

11 Z. ROBERTS: [Përkthim]

12 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Siç tha z. Kryegjykatësi, unë jam
13 Goeff Roberts. Jam Mbrojtësi i z. Selimi dhe i kam disa pyetje
14 që besoj se do na zgjasin gjatë gjithë seancës së pasdites së
15 sotme dhe nesër në mëngjes. E di që keni pritur midis pyetjeve
16 dhe përgjigjeve, dhe ndërkohë që keni dhënë dëshminë me anë të
17 përkthyesve më parë, por në qoftë se mund ta vazhdojmë ta
18 bëjmë një gjë të tillë do të ishte shumë mirë për sa i përket
19 transkriptit.

20 Së pari, mbi përvojën tuaj. Iu përgjigjët pyetjes së
21 Prokurorisë lidhur me përvojën tuaj, ju thatë keni shërbyer në
22 ushtrinë territoriale, pastaj si rezervist në Norvegji, Qipro
23 dhe Gjermani dhe thatë që keni qenë në kohë të pjesshme.

24 Si ka funksionuar kjo me kohë të pjesshme? Nënkupton kjo
25 që keni qenë në shërbim disa javë gjatë vitit, apo si?

1 PË. Po. Është një kombinim i fundit të javës dhe një periudhe
2 të dislokimit në njësi për dy javë në vit, si dhe kurset e
3 trajnimit. Kam bërë kurse të tilla në pjesë të ndryshme lidhur
4 me pozitën që kam patur si me këmbësorinë, me shërbimin e
5 ndërlidhjes, me shërbimin e mortajave, e kështu me radhë.
6 Përveç kësaj ne kemi bërë operacione të rekonjicionit në zonën
7 e dislokimit në Gjermani.

8 Më lejoni të shtoj sidoqoftë se në pjesën e parë të
9 shërbimit tim me njësinë e këmbësorisë, kjo ka zgjatur në kohë
10 të pjesshme, ka qenë punë e vështirë dhe ka zgjatur shumë
11 ditë, por me gjithë këtë ka qenë gjithsesi në kohë të
12 pjesshme. Përpara se të shërbeja në Ballkan apo në Bosnjë apo
13 në Kosovë, në atë kohë nuk kam patur një punë tjetër me kohë
14 të plotë. Dhe kryesisht kur kam qenë si oficer i ndërlidhjes
15 unë kam kaluar mjaft kohë i veshur me uniformë. Pagesa ishte
16 në nivelin e nënkolonelit dhe e kam kombinuar me punë të
17 tjera, me punë të pjesshme.

18 Kështu që në fakt kam shërbyer mjaft nën uniformë. Dhe
19 kam bërë -- në atë kohë në fakt nuk isha më amator, nuk ishte
20 më punë amatore si të thuash.

21 PY. Shërbimi i parë në front ka qenë në konfliktin në Gjirin
22 Persik?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe sa kohë jeni dislokuar?

25 PË. Rreth tre muaj.

1 PY. Rreth tre muaj, dhe pastaj më duket që ju thatë që ishit
2 në vitin 1996 pas 6 vitesh që keni shërbyer në Bosnjë. Kështu
3 është?

4 PË. Po, kështu është.

5 PY. Sa kohë keni shërbyer në Bosnjë në këtë cilësi?

6 PË. Gjatë një viti.

7 PY. Gjatë gjithë 1996?

8 PË. Jo. Unë u dislokova rreth majit, pas trajnimit fillestar,
9 dhe ndryshoi pozicion im, u rrita në detyrë në vjeshtën dhe më
10 pas iu ktheva jetës civile në maj të vitit të shkuar, pra ka
11 qenë në 1996 deri në 1997.

12 PY. Pra ka qenë që nga maji 1996 deri në maj 1997. Por
13 sidoqoftë nga 1991 deri në 1996 ju keni shërbyer në cilësi si
14 civil në Britani, apo jo?

15 PË. Po, bashkë me disa punë të tjera të natyrës ushtarake.

16 PY. Dhe gjatë kohës që keni shërbyer në Bosnjë? Keni shërbyer
17 si një zyrtar ndërkombëtar në ndihmë për procesin e
18 zgjedhjeve?

19 PË. Jo, kjo nuk ishte në cilësi ushtarake. Unë kam shërbyer
20 si një nëpunës i vëzhgimit të zgjedhjeve për disa zgjedhje në
21 Bosnjë në emër të ministrisë së jashtme britanike, por gjatë
22 kohës që kam shërbyer, fillimisht me IFOR-in dhe më pas me
23 SFOR-in, unë isha ekspert i selinë tonë lidhur me një numër
24 fushash, një nga të cilat kishte të bënte me zgjedhjet, dhe
25 për këtë arsye isha përfaqësuesi apo personi përgjegjës për sa

1 i përket planifikimit në nivelin e komunave. Ky ishte një nga
2 detyrat që kam kryer, detyrë e rëndësishme, por jo e vetmja.
3 PY. Dhe gjatë kohës që ishit ju në Bosnjë, atëherë kishte
4 përfunduar konflikti, kështu që nuk ka patur forca të
5 armatosura të asnjërës palë në atë kohë që të ishte aktive apo
6 jo.

7 PË. Ka patur disa aktivitete të snajperistëve, por jo
8 aktivitete ushtarake që të kërkonte përfshirjen tonë.

9 PY. Pra, përpara se të dislokohehit në Kosovë, a mund të
10 thuhet atëherë që ju nuk keni shërbyer asnjëherë në ndonjë
11 situatë ku ti ke patur një grup të armatosur joshtetëror që të
12 ishte aktiv?

13 PË. Në Bosnjë ka pasur disa fraksione, siç e dini ju. Kanë
14 ekzistuar grupe të cilat ishin të lidhura me shtetin, por kjo
15 ishte e ndaluar në bazë të marrëveshjes së Dejtonit. Pala
16 boshnjake kishte për shembull disa që quheshin Noelet
17 [fonetikisht] e Zeza. Për sa na përket neve, ata nuk ishin një
18 grup legal i miratuar për afërsisht se më vonë ata u bënë pjesë
19 e forcat e armatosura. Pra ka ekzistuar një gjë e tillë.

20 PY. Por, nuk keni marrë pjesë në një konflikt të armatosur
21 jondërkombëtar. Pasi një gjë e tillë nuk ka ndodhur në Bosnjë
22 në atë kohë në 1996 kur ishit atje?

23 PË. Po.

24 PY. Le ta përfundojmë këtë pyetje. E di që jeni jurist, por
25 nuk keni qenë ndonjëherë ekspert apo dëshmitar për çështje

1 ushtarake në ndonjë procedurë ligjore, apo gjyqësore?

2 PË. Jo.

3 PY. Dje sigurisht që nuk keni botuar ndonjë gjë sa i përket
4 grupeve joshtetërore lidhur me këtë? E di që keni botuar
5 lidhur me votimin në zgjedhjet e përgjithshme për forcat e
6 armatosura, por jo për aktorët joshtetërorë, jondërkombëtarë
7 në forcat në konfliktet e armatosura, ju nuk keni botuar
8 ndonjë gjë të kësaj natyre apo lidhur me fushë?

9 PË. Jo.

10 PY. A mund të konfirmoni se kur jeni dislokuar në 1998
11 ekzaktësisht në Kosovë?

12 PË. Nuk më kujtohet data e saktë. Besoj se ishte në nëntor.

13 PY. Nëse mund t'ju ndihmoj te deklarata që i keni dërguar ju
14 Tribunalit të Hagës thotë nëntori 1998. Nuk e di, doja ta
15 dija, nëse mund të jeni i saktë në fillim apo nga fundi i
16 nëntorit ka ndodhur një gjë e tillë?

17 PË. Nuk ishte në fund, por nuk e them dot me saktësi. Përpara
18 asaj kemi bërë trajnim në Mbretërinë e Bashkuar.

19 PY. Dhe atëherë në qoftë se themi që ishte në mes të
20 nëntorit, dokumenti që ju është treguar më herët është data 19
21 nëntor që do të ishte në fakt menjëherë pasi të kishit
22 mbërritur?

23 PË. Ndoshta po, por nuk e konfirmoj dot. Nuk e di ditën e
24 saktë të dislokimit. Ju kërktoj ndjesë.

25 PY. A mund të shpjegoni se ku keni qenë i vendosur gjatë

1 gjithë kohës së dislokimit tuaj, apo ka ndryshuar vendndodhja
2 juaj?

3 PË. Po, ka ndryshuar. Fillimisht fluturoam për në Beograd, ku
4 kaluam një natë, morëm makinat tona të blinduara. Unë isha një
5 nga shoferët, pasi isha trajnuar për të ngarë këtë makinë.

6 Më pas shkuam në Prizren, në Kosovë, ku të gjithë ne në
7 grupin tim, që ishim pjesa e KDOM-it Britanik, fillimisht
8 qëndruam në një hotel në Prizren, ku çdo ditë shkonim në zonën
9 që mbulonte qendra jonë koordinuese.

10 PY. Cila ishte kjo zonë e koordinimit nga ana e qendrës suaj?

11 PË. Ishte me qendër në Rahovec. Dhe nga aty shkonte në
12 drejtim të veriut dhe përfshinte Malishevën. Ishte një zonë ku
13 kishte pasur luftime të rënda gjatë verës së 1998, dhe
14 mendohej në atë kohë që ishte një pjesë mjaft e ndjeshme e
15 Kosovës. Megjithatë, fillimisht ne patrullonim gjatë ditës dhe
16 ktheheshim para se të binte errësira. Megjithatë kjo ndryshoi
17 shumë shpejt.

18 PY. Kur folët për luftimet e verës 1998, dëmtimet e kësaj
19 lufte ishin mjaft të dukshme në atë kohë në Malishevë dhe në
20 Rahovec, apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Në cilën zonë të UÇK-së ndodhej kjo zonë e përgjegjësisë
23 suaj?

24 PË. Zona 3, që është njohur po ashtu si zona e Pashtrikut.

25 PY. Dhe pse e keni quajtur zona 3, kështu jua kanë treguar

1 këtë zonën me numër?

2 PË. Po. Kështu e kam kuptuar unë. Termi i përdorur ishte
3 Pashtrik, por ishte e qartë që ishte një zonë e UÇK-së.

4 PY. Po të thoja unë që nuk ishte zona 3, do t'ju vinte çudi,
5 apo jo?

6 PË. Do të më çudiste, por nuk kam vështirësi për ta pranuar
7 një gjë të tillë.

8 PY. A e dini se cilat brigada të UÇK-së kanë patur
9 përgjegjësi lidhur me këtë zonë të përgjegjësisë tuaj që ishte
10 qendra CC1?

11 PË. Brigadat 122, 124 janë ato me të cilat jam takuar. Por
12 nuk them dot që të di se cilat ishin kufijtë e brigadave të
13 ndryshme, pasi kjo mund të ndryshonte. Megjithatë, numrat e
14 brigadave me të cilat i kam njohur më mirë janë 122 dhe 124.

15 PY. A keni udhëtuar edhe jashtë zonës së përgjegjësisë suaj
16 gjatë kohës që jeni dislokuar në Kosovë?

17 PË. Po.

18 PY. Ku?

19 PË. Kur shërbeva si komandant i patrullës me qendër në
20 Malishevë -- a po pyesni lidhur me kufijtë tanë apo kufijtë e
21 UÇK-së?

22 PY. Unë po flas për juve personalisht, në dislokimin tuaj. Ju
23 jeni dislokuar si pjesë e CC1, CC1 ka mbuluar Rahovecin dhe
24 Malishevën dhe shumica e punës suaj është bërë brenda kësaj
25 zone, apo jo?

1 PË. Po, megjithatë më lejoni ta cilësoj pak. Qendra jonë
2 koordinuese ka dislokuar njerëzit aty ku ka patur incidente,
3 në qoftë se vendasit na njoftonin që janë gjetur kufoma, janë
4 parë kufoma në një vend të caktuar. Ne nuk kemi patur kufij si
5 kufijtë ushtarakë -- por kur bëhet fjalë për armatimin nuk
6 kalohen këto kufij, ne nuk ishim -- duke qenë që ne nuk ishim
7 të armatosur, ne nuk i kemi parë kufijtë si të vendosur.

8 Kështu që patrullat tona arrinin jashtë kufijve të zonës
9 sonë edhe përpara se të kishin mbërritur atje personat
10 përgjegjës të selisë së OSBE-së. Ishte thjesht se ne ishim
11 ndër të parët, kishim përvojë, kishim makina të blinduara dhe
12 në fakt ishim dhe më të shumtë në numër.

13 PY. Sa për ta bërë të qartë, këtu bëhet fjalë për distanca
14 shumë të shkurtra. Jo se shkonit me distanca shumë të gjata,
15 për të arritur në Kosovën veriore, apo verilindore.

16 PË. Po, disa nga ne e kanë bërë, nuk e kanë bërë vetë, disa
17 janë dërguar.

18 PY. Unë jam i interesuar të di nga ato që keni parë, dëgjuar
19 dhe për të cilën mund të jepni dëshmi ju vetë personalisht.

20 Pra, ju nuk keni shkuar në zonat e tjera të UÇK-së përveç
21 këtyre udhëtimeve të shkurtra? Por për sa i përket zonave të
22 tjera ju nuk jeni dislokuar në zona të tjera?

23 PË. Po, është e saktë. Me përjashtim të një turneu të
24 orientimit që kemi bërë që në fillim të dislokimit tonë.

25 Momenti ku atasheu britanik i asaj kohe --

1 PY. Ishte Sean [sipas përkthimit] Crosland?

2 PË. Po. Gjatë kësaj kohe kam parë një pjesë të madhe të të
3 gjithë vendit, të pjesës tjetër të vendit. Kryesisht pjesës
4 perëndimore.

5 PY. A ju ka dhënë ai ndonjë ide lidhur me nivelin e
6 organizmit të UÇK-së në kohën e dislokimit tuaj në tetor-
7 nëntor?

8 PË. Nuk më kujtohet ndonjë seancë informuese e veçantë e
9 kësaj natyre.

10 PY. Mund t'i kthehemi kësaj çështje për të parë në qoftë se
11 ajo që na ka thënë ai përputhet me atë që dini ju. Po t'i
12 kthehemi një herë çështjes së patrullimit dhe vlerësimit tuaj.
13 Ju e pranoni në vija të trasha, që komentet që keni dhënë në
14 deklaratën tuaj lidhur me nivelin organizues dhe zinxhirin
15 komandues të UÇK-së, vjen nga njohurit që keni patur në zonën
16 tuaj të përgjegjësisë në CC1?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe nuk mund të përfshijë datat apo kohën kur ju keni
19 qenë i dislokuar atje. Bëhet fjalë për datën 15 nëntor pa
20 dhënë një datë të saktë deri më datën 19 mars kur jeni
21 larguar, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Bëhet fjalë sigurisht për 1999. Zotëri, dua të diskutojmë
24 disa nga opinionet tuaja në qoftë se mund ta shfrytëzoj këtë
25 term, lidhur me organizimin e UÇK-së në atë zonë të caktuar.

1 Në deklaratën tuaj, mund ta vendos në ekran nëse
2 dëshironi, në paragrafin 118 të deklaratës suaj për ZPS-në, e
3 ka numrin P392, për sa i përket procesverbalit. I thotë ZPS-së
4 sipas mendimit tuaj UÇK-ja ishte e organizuar shumë mirë dhe
5 kishte komunikime të arsyeshëm duke patur parasysh distancat
6 dhe terrenin për të cilin bëhej fjalë.

7 A ju kujtohet që e keni thënë një gjë të tillë?

8 PË. E keni nxjerrë jashtë kontekstit kur thoni "shumë e
9 organizuar". Nuk them që s'e kam përdorur atë term, atë frazë,
10 por organizimi i tyre nuk mund të krahasohet për shembull me
11 një ushtri moderne e cila kontrollonte territorin e saj.

12 Kjo është pjesë e kontekstit të një organizate ushtarake
13 e cila ishte në zhvillim e sipër nga njëra anë, dhe në
14 ndryshim e sipër nga ana tjetër. Por nuk ishte një seri
15 guerrilasish në fshatra të cilët nuk komunikonin njëri me
16 tjetrin.

17 PY. Pikërisht këtë doja të kuptoja, doja të kuptoja se çfarë
18 nënkuptuat me atë që keni thënë në deklaratën tuaj, pasi fraza
19 të kësaj natyre kanë kuptim të ndryshëm në kontekste të
20 ndryshme. Ju flisni këtu për një nivel të organizimit në atë
21 kohë. Dhe ky vlerësim është i shkurtit, marsit 1999, ky
22 vlerësimi juaj?

23 PË. Kjo do të ishte pika kur do të ishte e mirë-zhvilluar. Në
24 kohën e rrëmbimit të z. Xhafiqi, e zhvilluar deri në këtë
25 fazë, unë do të ngurroja të thoja që të kishte qenë e njëjtë

1 në momentin kur kemi arritur fillimisht, pasi po të kishte
2 qenë e njëjtë në momentin që ne do të kishim mbërritur, unë
3 nuk do të isha dëshmitari që do të thoja një gjë të tillë,
4 pasi unë nuk e kam bërë atë vlerësim në atë kohë.

5 PY. Komentet e tjera që keni bërë në deklaratën tuaj. Ju
6 thatë që UÇK-ja, dhe ky është paragrafi 20, nuk ka patur grada
7 ushtarake apo emblema, por ka patur një sistem të lartë të
8 hierarkisë në mangësi të gradave zyrtare?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe mbi ç'bazë e thoni një gjë të tillë?

11 PË. Vëzhgimi që kam bërë gjatë momentit që jam takuar me
12 komandantë të ndryshëm dhe fakti që ushtarakët i ndiqnin
13 urdhrat e tyre, kjo ishte krejt e dukshme, respektoheshin.
14 Ishte diçka që unë e vija re shumë lehtë, pasi ishte gjë e
15 rëndësishme për ne. Bëhej fjalë për një organizatë të
16 disiplinuar për njerëz të cilët ishin dedikuar ndaj njëri-
17 tjetrit dhe të ardhmes në këtë pjesë të botës.

18 PY. Po, nuk vihet në dyshim dedikimi, por pyetja që ngrihet
19 është se sa të organizuar kanë qenë, si ka funksionuar
20 zinxhiri komandues? Ju thatë lidhur me vëzhgimet që keni bërë
21 gjatë takimeve me komandantë të ndryshëm.

22 Në deklaratën tuaj keni deklaruar që keni takuar dy herë
23 Komandantin Drini, dhe në shënimin përgatitor e korrigjuat një
24 gjë të tillë, thatë që e keni takuar vetëm një herë, kështu
25 është?

1 PË. Po, kjo është e saktë. Mesazhi që kam parë që m'i ka
2 treguar ZPS-ja, nga mesazhi kam parë që në fillim kisha takuar
3 dy herë Drinin, dhe pastaj m'u bë e qartë që nuk ishte kështu,
4 dhe u përpoqa që ta kuptoja se çfarë kisha thënë. Megjithatë,
5 jam i saktë kur them që e kam takuar Drinin ditën e --

6 PY. Më datën 9 mars.

7 PË. Po, më datën 9 mars. Dhe më kujtohet shumë mirë kjo.
8 përveç kësaj kam edhe shënimet që kam mbajtur, por edhe
9 shënimet të cilat i a kam dhënë Gjeneralit Maisonneuve, të
10 cilat ai i ka paraqitur përpara Tribunalit të Hagës. Janë
11 shënimet e mbajtura në atë kohë. Megjithatë, mua më kujtohet
12 shumë qartë biseda që kam patur në gjuhën angleze me Drinin.
13 Kjo pjesë ishte shumë e qartë.

14 A e kam takuar atë ndonjëherë tjetër? Kam arritur në
15 përfundimin që unë mendova që mund ta kisha takuar në ditën e
16 dislokimit të mortajave në Zeqishtë, por kam takuar një
17 komandant tjetër, Skënderin.

18 Dhe arsyeja pse m'u kujtua Drini në atë kohë, është sepse
19 procesi i goditjes me mortajë ishte bërë pas urdhrave të tij.
20 Komandantët UÇK-së që kemi biseduar më thanë që Drini e kishte
21 dhënë këtë urdhër. Dhe i kishin dhënë palës serbe një gjë të
22 tillë --

23 PY. Ju kërkoj ndjesë që po ju ndërpres. Po përpiqem që ta
24 kalojmë sa më shpejt të jetë e mundur këtë proces. Por e
25 kuptoni që në deklaratën tuaj kishit bërë gabim. Ju keni

1 besuar që e keni takuar atë dy herë, por nuk e keni takuar dy
2 herë, dhe ky ishte gabim, apo jo?

3 PË. Po. Dhe e kam korigjuar këtë. Si pjesë e shënimit
4 përgatitor.

5 PY. Po kjo është hera e parë që e keni takuar Drinin, një
6 herë. A keni takuar ndokënd tjetër nga komanda e zonës së
7 Pashtrikut gjatë kohës që ju keni shërbyer në CC1?

8 PË. Për çfarë niveli komandues? Sigurisht që kam takuar
9 pjesëtarë të kësaj organizate. E keni fjalën për ndonjë nivel
10 të caktuar?

11 PY. E kam fjalën për shtabin i komandës së Pashtrikut.
12 Faleminderit për sqarimin, duhet të isha treguar më i saktë në
13 pyetjen time.

14 PË. Nuk më kujtohet ndokush tjetër përveç personit me të
15 cilin mbanim ndërlidhje me OSBE-në. E kam përmendur këtë
16 person në deklaratën time. Personi i caktuar që të mbante
17 ndërlidhjen me MVK-në [sipas përkthimit] që ishte pjesë e asaj
18 selie.

19 PY. Pra, bashkëpunimi juaj me UÇK-në dhe shtabin e zonës
20 kalonte përmes një ndërmjetësi. Është personi të cilin e keni
21 takuar në mëngjesin e 9 marsit, kështu është?

22 PË. Po.

23 PY. Por ju nuk keni patur kontakte të drejtpërdrejta me
24 shtabin e zonës apo jo?

25 PË. Po, ashtu është.

1 PY. Në intervistën tuaj, ju thatë që nuk keni patur njohuri
2 të sakta lidhur me strukturën e brigadave dhe dislokimin e
3 tyre në zonën e Pashtrikut. Kjo është paragrafi 19 i
4 deklaratës suaj, nuk keni patur njohuri të hollësishme,
5 atëherë dhe tani nuk keni ndonjë hollësi të mëtejshme lidhur
6 me strukturën dhe me dislokimin e brigadave?

7 PË. Po, e saktë.

8 PY. Për sa i përket kreut të organizatës, asaj që ju besoj që
9 e keni quajtur Shtabi i Përgjithshëm. Në deklaratën tuaj e
10 keni bërë të qartë që nuk e dini që kur është krijuar Shtabi i
11 Përgjithshëm. Po e lexoj. Është paragrafi 122.

12 "Nuk e di se kur është krijuar Shtabi i Përgjithshëm."

13 E saktë apo jo?

14 PË. E saktë.

15 PY. Dhe pastaj thatë:

16 "CC1 nuk ka mbajtur takime të sakta apo nuk kishte
17 praktike që të takohej me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së."

18 Doni ta vazhdoj kështu apo të bëj pyetje të tjera?

19 PË. Po. Vazhdoni, me pyetjet vijuese.

20 PY. Por ju nuk e dini se kur është emëruar ky Shtabi i
21 Përgjithshëm dhe nuk keni kërkuar kontakte me ta, kështu
22 është?

23 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë shoh se
24 ka arritur koha. Tani do kaloj në një tematikë tjetër. E shoh
25 që mund të jetë momenti i përshtatshëm për ta përfunduar këtu.

1 Dëshmitar, faleminderit. Do ta rifillojmë nesër në
2 mëngjes.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
4 që erdhët me neve, do të rikthehemi sërish në 9.00, ditën e
5 nesërme. Mbani parasysh paralajmërimin që ju kam bërë për të
6 mos biseduar lidhur me këtë çështje gjyqësore jashtë sallës së
7 gjyqit, dhe të na tregoni nëse dikush ju kontakton juve.
8 Sekretaria do t'ju ndihmojë të dilni nga salla e gjyqit.

9 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Në qoftë se është momenti i
12 përshtatshëm apo nesër është një çështje me të cilën duhet t'i
13 drejtohem Trupit Gjyqësor. Do të kërkojmë që të na shtyhet
14 afati për përgjigjen ndaj parashtrimit të protokolluar 1764.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk kisha
16 mikrofonin.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Është një çështje që duhet t'i
18 drejtohem Trupit Gjyqësor sot apo nesër. Dua të kërkoj që të na
19 shtyhet afati për përgjigjen tonë ndaj parashtrimit të
20 protokolluar 1764 që është parashtrimi i Prokurorisë për sa i
21 përket rregullës 107.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa kohë
23 kërkon?

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Shumë e shkurtër.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa?

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Do ta kishim bërë pak më herët, por
2 kemi shumë të angazhuar me përgatitjen për dëshmitarët gjatë
3 kësaj jave. Kërkohej përgjigje nesër, do të kërkoja që të
4 shtyjmë deri të hënën e ardhshme.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
6 kundërshtim?

7 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po,
9 miratohet.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mund të ngre dy çështje tani.
11 Seanca në publik dhe në privat që është bërë me argumentin
12 ligjor që është bërë pak më herët. Ndoshta kemi bërë një
13 gabim. Është bërë shumica e tij në seancë private dhe nuk ka
14 asgjë që të justifikojë mbajtjen e tij në seancë private.

15 Dhe prandaj mund të kërkoj që të nxirrnit një urdhër tani
16 apo nesër në mëngjes që ky argument ligjor të jetë i
17 disponueshëm për publikun me qëllim që edhe transkripti dhe
18 videoja të jetë e disponueshme për publikun, të jetë publike.

19 E dyta, pavarësisht asaj që kemi diskutuar më herët
20 lidhur me seancat publike, krahasuar me ato publike, dhe
21 çështjes që ne mund ta shikojmë transkriptin pak më vonë do
22 mund ta bëjmë publike asgjë nuk është bërë për të realizuar
23 këtë objektiv me sa di unë.

24 Dhe do t'ju kërkoja juve, të nderuar Gjykatës, që të më
25 jepni një afat që palët të japin përgjigjet e tyre tani. Ka

1 disa muaj që ka filluar ky gjyq, dhe është një material mjaft
2 i madh i cili do të duhej që të ishte publikuar si transkripti
3 i redaktuar, dhe nuk mund të vazhdojmë në këtë mënyrë pasi ka
4 shqetësime siç e dimë të gjithë lidhur me këtë gjyq dhe pjesën
5 e tij që zhvillohet në publik.

6 Pra, me çështjen e parë besoj se nuk ka asnjë argument
7 kundër lirimit apo publikimit të argumentit ligjor që ishte në
8 kuadrin e dëshmitarit të fundit.

9 Për sa i përket çështjes më të përgjithshme ne jemi të
10 gjithë fajtorë së bashku që nuk kemi zbatuar këtë sistem të
11 cilin e kemi premtuar që do ta zbatojmë, që do të thotë që pas
12 përfundimit të secilit dëshmitar, do të duhet të zhvillohet
13 një proces për të identifikuar atë që duhet liruar për
14 publikun.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta shkojmë
16 këtë.

17 Dëshironi të përgjigjeni, Prokuroria?

18 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në qoftë se argumenti është bërë
19 në seancë private, dhe na lejoni që të shikojmë gjatë kësaj
20 mbrëmje për të parë në qoftë se ka ndonjë gjë të
21 papërshtatshme, dhe nuk kemi kundërshtim për ta liruar këtë në
22 qoftë se nuk ka problem.

23 Edhe për sa i përket e dyta, jemi të lumtur që të
24 funksionojmë *inter partes* për ta bërë këtë. E kemi bërë këtë
25 vetëm për një dëshmitar --

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë do të
2 dëshiroja që kjo të fillonte me një diskutim *inter partes* nëse
3 --

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk jam i sigurt se nëse nuk e
5 kemi bërë këtë pasi të gjitha transkriptet nuk është ndoshta
6 liruar apo është nxjerrë ndonjë transkript. Ne mund ta
7 fillojmë këtë, mund ta bëjmë këtë *inter partes*.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne kemi një
9 javë në dispozicion tani, dhe në fund të javës ndoshta mund të
10 vini me një plan të cilin të na e paraqisni ditën e hënë kur
11 të fillojmë seancën tonë të gjykimit.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe ju lutem
14 që gjatë kësaj darke të shikoni argumentin ligjor që kemi bërë
15 dhe të ndërmarrim veprimin e duhur që duhet marrë lidhur me
16 këtë çështje.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A kishit
18 diçka për të thënë?

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] Dy gjëra. E para, ndoshta mund të
20 më duhet kohë më e madhe nesër në mëngjes, por jo më shumë se
21 ajo që kisha vlerësuar. Dhe e dyta, për sa i përket zgjatjes
22 së afatit për z. Ellis, të cilin e miratoi Trupi Gjykses,
23 besoj se kjo ka të bëjë me të gjitha ekipet e palëve
24 Mbrojtëse, apo jo?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se

1 nuk ka kundërshtim, por ka vlerë për të gjitha ekipet e
2 Mbrojtjes.

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë gjë
5 tjetër?

6 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtu e
8 përfundojmë. Takohemi sërish nesër në 9.00.

9 --- Seanca mbyllet në orën 16.03

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25